



Rexhep ISMAILI

**MBYTJA VRASJA
E NJERIUT NË ISLAM**

Rexhep ISMAILI

MBYTJA-VRASJA

E NJERIUT NË ISLAM

Kumanovë
2015

Autor

Rexhep Ismaili

Titulli i librit:

MBYTJA-VRASJA

E NJERIUT NË ISLAM

Recensentë:

Doc.Dr. Rexhep Boja

Dr. Lulzim Esati

Prof. Emin Behrami

Lektor:

Agim Avdiu

Përgatitja kompjuterike & dizajni:

Jusuf Saliu

Shtypi:

Furkan ISM – Shkup

Tel./Fax. (02) 26 22 360

<http://www.furkan.com.mk>;

“...kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit...” (Maide 32)

“Mbytja e besimtarit konsiderohet mëkat më i madh se sa shkatërrimi i gjithë kësaj bote.”(Sunen et Tirmidhij)

”E kuptoj perfekt të drejtën e paqes; kjo e drejtë nënkupton mbajtjen e fjalës për t'i siguruar çdo njeriu të gëzojë plotësisht të drejtat e tij natyrore, mirëpo nuk di ç'është e drejta e luftës. Një kodeks për vrasje më duket një konceptcion i çuditshëm.” (Volteri)

Përkushtim:

Në emër të Allahut, mëshiruesit, mëshirëbërsit.

“Këtë libër ia përkushtoj në veçanti gjyshit tim, por edhe mbarë familjes time të cilët me dhanë përkrahje dhe mbështetje morale në arritjen e suksesit tim. Gjyshi im ka qenë një njeri i cili e ka dashtë shumë arsimimin, edukimin dhe përkushtimin ndaj fesë dhe kombit, ndaj dhe me punën time kam dëshiruar dhe shpresuar gjithmonë, se jam duke ecur në rrugën që na e mësoi ai.”

Tërë falënderimi i qoftë Allahut, përmes begative të të Cilit kryhen veprat e mira.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
28:17

ISMAILI, Rexhep

Мбытја-врасја е нjeriut në islam / [autor Rexhep Ismaili]. -
Kumanovo : R. Ismaili, 2015. - 125 стр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 119-122

ISBN 978-608-245-047-6



а) Ислам - Етички аспекти
COBISS.MK-ID 97858570

بسم الله الرحمن الرحيم

الحمد لله رب العالمين و الصلاة و السلام على رسولنا
محمد و على اله و صحبه و من تبعهم بإحسان إلى يوم
الدين و بعد:

Hyrje

I tërë falënderimi i singertë i takon vetëm All-llahut, prej Tij ndihmë dhe falje për mëkatet tona kërkojmë. Prej All-llahut kërkojmë mbrojtje nga të ligat e vetvetes dhe nga të këqijat që vijnë nga veprat tona. Atë që e udhëzon All-llahu, nuk ka kush që e devijon e kush devijon atë njeri, nuk ka dikush tjetër që e udhëzon përpos Tij. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër pos All-llahut, Një, të Vetëm i cili nuk ka shok dhe besoj se Muhamedi është rob i Tij dhe i dërguari i Tij të cilin e dërgoi me udhëzim dhe me fenë e drejtë që të dominojë mbi të gjitha fetë tjera e mjafton All-llahu si dëshmitar, ndërkaq paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi të dërguarin e All-llahut, familjen dhe mbi shokët e tij.

Vrasja dhe sjelljet e ndryshme kriminale të vrasjes në botën e sotme, janë bërë temë dite e shtypit të përditshëm, e revistave dhe e mjeteve elektronike të informimit. Programet filmike, televizive, video-klubet, faqet e internetit dhe repertorët e kinemave janë përplot me tema dhe me përmbajtje të krimeve, të dhunës, vrasjeve, dhunimeve seksuale, kidnapi-meve, plaçkitjeve, pornografisë, aferave, skandaleve dhe

sjelljeve tjera patologjike dhe kriminale. Këto përmbajtje që prezantohen ndër lexuesit dhe shikuesit përcjellin porosi negative, duke nxitur e zgjuar ndjenja dhe instinkte të ulëta, sidomos të të miturit dhe të rinjtë. Në këtë mënyrë, tema e krimit të vrasjes është prezent në të gjitha poret e jetës së njeriut në shoqërinë bashkëkohore. Pikërisht kjo është arsyeja kryesore që më ka shtyrë mua të shkruaj për këtë temë, duke bërë pyetje, pse e gjithë kjo vrasje e gjakderdhje në tokë të njerëzve të pafajshëm. Nuk jam as i pari dhe as i fundit që hulumtoj për këtë temë. Kanë shkruar dhe do të shkruajnë në të ardhmen gjenerata të reja. Unë jam munduar që me njohuritë e mia duke u mbështetur në Kur'an dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. të bëj një elaborim të shkurtër në lidhje me vrasjen. Siç dihet, për shekuj me radhë, akte të ndryshme të vrasjes janë kryer në vende të shumta të botës nga grupe të ndryshme për qëllime të ndryshme. Disa herë organizatat komuniste, disa herë grupet fashiste, e nganjëherë fraksionet radikale e separatiste, mbajnë përgjegjësinë për akte të këtilla. Vrasja e njerëzve të pafajshëm është një mëkat i madh që çon në vuajtje të tmerrshme në Ferr. Asnjë njeri që beson dhe që i trembet dënimit të Zotit, nuk do ta bënte kurrë diçka të tillë. Feja urdhëron për dashuri, mëshirë dhe paqe. Vrasja, nga ana tjetër është e kundërta e fesë; është mizor, i pamëshirshëm dhe kërkon gjakderdhje e mjerim. Terrori (d.m.th. vrasja e njerëzve të pafajshëm) në islam është një mëkat i madh dhe muslimanët janë të ngarkuar me përgjegjësinë për t'i parandaluar këto akte dhe për të sjellë paqe e drejtësi në botë.

All-llahu i lartmadhërishtëm në mënyrë të prerë ndalon vrasjen njeriut duke porositur muslimanët dhe njerëzit në përgjithësi:

وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ

“Dhe mos mbytni njeriun që All-llahu ka ndaluar (mbytjen e tij), përveç me drejtësi”.¹

Një gjë të tillë e potencon edhe Muhamedi a.s. ku thotë: “*Shkatërrimi i kësaj bote është më i lehtë te Zoti sesa vrasja e një besimtari pa të drejtë*”. Këtë temë jam munduar që në pika të shkurta ta sqaroj, se vrasja është krim i rëndë dhe e ndaluar nga ana e All-llahut dhe Muhamedit a.s.

Këtë temë e kam ndarë në tre kapituj. Në kapitullin e parë kam folur se njeriu është i vlefshëm pa dallim feje, race apo ngjyre, pastaj historiku i mbytjes, mbytja në luftëra e konflikte, në tradita dhe zakone. Në kapitullin e dytë kam folur për mbytjen e njeriut në islam, mbytja e njeriut pa të drejtë në islam është e ndaluar, vetëdija fetare dhe ndikimi i saj në pengimin e mbytjes, islami e ndëshkon mbytësin. Në kapitullin e tretë kam folur për mbytjen e njeriut sipas sheriatit islam, duke potencuar gjithashtu për llojet e vrasjeve dhe për masat ndëshkimore për vrasje, gjithashtu edhe për sanksionet në disa ligje tjera të botës dhe në fund pajtimet. Dhe në fund, duke falënderuar All-llahun që më ndihmoi në përmbylljen e kësaj teme.

¹. El Isra 33

KAPITULLI I PARË

MBYTJA (vrasja)

- » NJERIU DHE VLERA E TIJ
- » HISTORIKU I MBYTJES (i vrasjes) SË NJERIUT
- » MBYTJA (vrasja) NË LUFTËRA DHE KONFLIKTE
- » MBYTJA (vrasja) NË TRADITA DHE ZAKONE

NJERIU DHE VLERA E TIJ

Islami i cili bazohet në besimin dhe idenë për njëshmërinë e Zotit, urdhëron për paqe dhe drejtësi mbarëbotërore. Vetë etimologjia e fjalës islam e ka kuptimin paqe, rehati dhe siguri, por të gjitha këto mund të realizohen vetëm nëse personi i nënshtrohet të Gjithëfuqishmit.

Të jesh kundër dhunës, vrasjes, tiranisë dhe parapëlqimi i drejtësisë do të thotë t'i jepet çdokujt e drejta që i takon, ndihmë dhe mbështetje juridike që ai t'i realizojë ato të drejta. Synimi i të gjitha feve dhe mesazheve pejgamberike është të sigurohet paqja, drejtësia midis të gjithë njerëzve. Si rezultat i domosdoshëm i kësaj, shmangen të gjitha dallimet sipërfaqësore dhe jo të rëndësishme racore, gjinore dhe klasore.

Zoti nuk është vetëm Zot i një fisi ose kombi, Ai është Zot i të gjitha botëve. Ai i ka krijuar të gjithë njerëzit. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

رَبِّ الْعَالَمِينَ

“Zotit të botëve.”²

Pejgamberi a.s. në lidhje me këtë, thotë:

وَالنَّاسُ بَنُو آدَمَ وَخَلَقَ اللَّهُ آدَمَ مِنْ تُرَابٍ

“Të gjithë njerëzit janë nga Ademi, kurse Ademi është krijuar nga toka.”³

Meqë materia antologjike e të gjithë njerëzve është një, atëherë dallimi në gjini, racë, pasuri, në status social ose klasë nuk mund që të jetë mjet ose shkak i epërsisë së dikujt ndaj dikujt tjetër. Fakti që njerëzit kanë identitet të ndryshëm

². El Fatiha, 1.

³. Transmeton Ibn Maxhe.

etnik, kulturor dhe social nuk është karakteristikë ndarëse, por bashkuese dhe pasuruese. Parimi universal që ka nxjerrë në dritë Kur`ani kur i është drejtuar njerëzimit, duke e proklamuar thirrjen e All-llahut xh.sh. drejtuar gjinisë njerëzore nëpër gjithësi me këto fjalë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْتُمْ مِّنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَكُمْ

شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۚ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَىٰكُمْ ۚ إِنَّ

اللَّهُ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾

“O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijsëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”⁴

Ky ajet kur`anor karakterizohet me disa gjëra.

E para: Nuk i është drejtuar një populli të veçantë apo vetëm pjesëtarëve të fesë islame, por i është drejtuar mbarë njerëzimit, kështu që në këtë ajet hyn çdokush që i takon llojit njerëzor, pa dallim race, ngjyre, shtrese shoqërore, feje, qofshin ata edhe nga idhujtarët apo prej atyre primitivë. A nuk janë të gjithë njerëz që jetojnë në sipërfaqen e tokës?

E dyta: Ajo që i bashkon që të gjithë është se ata janë të lindur prej një mashkulli dhe një femre, për t’i forcuar marrëdhëniet në mes të gjithë njerëzve, pa dallim. Kjo është e kundërta me atë që shohim sot me rastin e therjes së mitrës së nënës dhe të vrasjeve të njerëzve, duke e mbytur njëri-

⁴. El Huxhurat, 13.

tjetrin dhe duke e bërë jetën si një xhungël, ku i forti e gëlltit të dobëtin etj.

E treta: Ndarja e njerëzve në popuj e fise, gjini, raca, pasuri, status social ose klasë, një gjë e tillë nuk bën t'i ndalojë ata që të njihen në mes tyre dhe të gjithë të jetojnë në paqe dhe siguri.

Kjo thirrje erdhi për të themeluar dhe për të rrënjësuar parimin e vëllazërimit njerëzor, mu në kohën kur tirania dhe tendencat popullore kishin marrë kahe fisnore. Racizmi kishte marrë përmasa aq të mëdha, saqë bijtë e Hamit u shndërruan në robër dhe në shërbëtorë të bijve të Samit, mu ashtu siç predikonte Dhiata e Vjetër për tregimin e Nuhut a.s. gjëra që nuk ishin gjë veçse rrëfime mitologjike të shpikura prej njerëzve, të cilat përpos tjerash, urdhëronin që njerëzit e racës së zezë të ishin robër, ndërsa ata të racës së bardhë të ishin zotërinj. Realiteti ishte se njerëzit, që të gjithë ishin dhe janë femijë të një babai e një nëne,⁵ apo siç thoshte pejgamberi a.s.:

Kështu që prejardhja e njerëzve është një edhe pse ndryshojnë nga ngjyra, fisi, klasa etj.

Duke u nisur nga ky parim, i Dërguari i All-llahut xh.sh., Muhamedi a.s. në tubimin më të madh në haxhin e lamtumirës i dha fund ftesës së tij kur tha:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَلَا إِنَّ رَبَّكُمْ وَاحِدٌ وَإِنَّ أَبَاكُمْ وَاحِدٌ أَلَا لَا فَضْلَ
لِعَرَبِيٍّ عَلَى أَعْجَمِيٍّ وَلَا لِعَجَمِيٍّ عَلَى عَرَبِيٍّ وَلَا لِأَحْمَرَ عَلَى أَسْوَدَ
وَلَا أَسْوَدَ عَلَى أَحْمَرَ إِلَّا بِالتَّقْوَى

“O ju njerëz, ju keni vetëm një sundues dhe një të parë, nuk ka kurrfarë përparësie arabi ndaj joarabit dhe joarabi ndaj arabit, as i kuqi ndaj të ziut, e as i ziu ndaj të kuqit përveç në devotshmëri.”⁶

⁵. Dituria Islame, nr. 190, f. 20.

⁶. Musned “El - Imam Ahmed” v. 12, f. 226.

Në vazhdim i dërguari e la porosinë që të thirret në paqe, që është një nga kushtet e besimit në All-llahun xh.sh. duke tërhequr vërejtjen për krimin e gjakderdhjes që prapë është sulm ndaj All-llahut xh.sh.:

أَلَا تَرْجِعُوا بَعْدِي كُفَّارًا يَضْرِبُ بَعْضُكُمْ رِقَابَ بَعْضٍ

“Mos u ktheni pas meje në injorancë (laicizëm, mosbesim) duke sulmuar njëri tjetrin.”⁷

Në vazhdim të atij fjalimi dhe me qëllim që të çrrënjos bindjen e fiseve arabe lidhur me marrjen e gjakut, tha:

فَإِنَّ دِمَاءَكُمْ وَأَمْوَالَكُمْ وَأَعْرَاضَكُمْ عَلَيْكُمْ حَرَامٌ كَحُرْمَةِ يَوْمِكُمْ هَذَا فِي بَلَدِكُمْ هَذَا فِي شَهْرِكُمْ هَذَا

“Gjaku i njeriut.....është i shenjtë, sikur që është e shenjtë kjo ditë, ky muaj dhe ky vend.”⁸

Pra, jetën e njeriut e ngriti aq lart saqë e barazoi me ditën e Arafatit, që në islam konsiderohet dita më e shenjtë gjatë tërë vitit.

All-llahu xh.sh. në Kur'an në lidhje me këtë thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا ادْخُلُوا فِي السِّلْمِ كَآفَّةً

“O besimtarë! Rreshtohuni të gjithë në anën e paqes!”⁹

Nga kjo pikëpamje del se duhet t'u përmbahemi parimeve, sipas të cilave nuk ka mosmarrëveshje në bazë të besimit hyjnor, ndërsa këto parime janë nderi i njeriut ndaj All-llahut xh.sh., nevoja e të gjithë njerëzve për paqe, pa dhunë, pa vrasjen e njëri-tjetrit, pa armiqësi, përpjekje për të mirën e njeriut në pikëpamje shkencore, shoqërore dhe

⁷. Risalet el - xhihad, nr. 61, 1987, f. 69.

⁸. Sherif Ahmeti “Komente dhe mendime islame” Prishtinë, 1995, f. 270.

⁹. El Bekare, 208.

ekonomike, gjetja e zgjidhjeve që janë në interesin e njerëzve dhe që u siguron shpëtim.

Sa i përket jetës politike, islami obligon paqe midis njerëzve. Nuk pranon as epërsinë racore, klasore dhe as kombëtare, por proklamon barazinë dhe barabarësinë midis njerëzve. Muhamedi a.s. në një rivajet tjetër thotë: ***“Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, as i bardhi ndaj të ziut, por sipas masës së frikës ndaj Zotit.”***¹⁰

Sa për ilustrim do të cekim shembullin e shkurtë të arrestimit të zezakëve në Amerikë e Afrikë Jugore, vetëm nga shkaku se janë të zi.

Kur’ani para 14 shekujve e vuri në rend të ditës zhdukjen e ndarjes ndër njerëz, prandaj edhe i thirri të gjithë me një emër *“O ju njerëz”*. Kombeve të bashkuara u ra në sy nevoja e zbatimit të parimeve të Kur’anit vetëm në shekullin e XX, respektivisht më 10 dhjetor 1948 kur për herë të parë nxorën shpalljen sipas së cilës garantohet liria, e drejta për jetë dhe barazia e të gjithëve.¹¹

Buhariu transmeton se Ebu Dherri dhe Bilall Habeshiu (ishin prej të parëve që e kishin pranuar islamin) janë zënë mes veti dhe e kanë ofenduar njëri-tjetrin. Në atë gjendje hidhërimi, Ebu Dherri i thotë Bilallit: *“O biri i zezakes!”* Kur Bilalli u ankua te Pejgamberi a.s. për këtë ofendim, ai i thotë Ebu Dherrit: *“A e turpërove me nënën e tij? Ende ka në ty ndikim të periudhës së xhahilijetit (injurancës)!”*

E gjithë kjo është rezultat i faktit se islami e trajton tërë gjininë njerëzore si një familje dhe armiqësia kundër një anë-tari të saj, konsiderohet armiqësi kundër tërë gjinisë njerëzore.

¹⁰. Risalet el - xhihad, vep. cit. f. 69.

¹¹. Sherif Ahmeti vep. cit. f. 101.

Krimi është edhe më serioz kur ka të bëjë me të vrarin që beson në Zotin. All-llahu xh.sh. thotë:

وَمَنْ يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُتَعَمِّدًا فِجَزَاؤُهُ جَهَنَّمُ خَالِدًا فِيهَا

وَغَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُ وَأَعَدَّ لَهُ عَذَابًا عَظِيمًا ﴿٩٣﴾

“Kush e mbyt një besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehenemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. All-llahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh.”¹²

All-llahu xh.sh. gjithashtu thotë:

وَلَا تَقْتُلُوا النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ

“Mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu.”¹³

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë: ***“Besimtari vazhdon të jetë brenda sferës së fesë përderisa nuk derdh ndonjë gjak të ndaluar.”***¹⁴

Islami është fe e paqes, urdhëron për paqe dhe qëndron larg çdo fanatizmi, racizmi dhe padrejtësie në emër të nacionalizmit. Thirrja e tij është thirrje universale për tërë llojin njerëzor. Islami i trajton të gjithë njerëzit njësoj, duke u bazuar në parimin se të gjithë janë njerëz dhe se njeriu duhet te respektohet, nuk duhet te derdhet gjaku i tij dhe se ai ka të drejtën e jetesës, pavarësisht se cilës fe, fis, komb apo racë i takon. Për trajtimin e të gjithë njerëzve njësoj, më

¹². En Nisa, 93.

¹³. El En'am, 151.

¹⁴. Transmeton Buhariu.

së miri na mëson Pejgamberi a.s. në një rast kur ai ishte ulur me shokët e tij dhe para tyre kaloi një kufomë e një hebreu, ndërsa Pejgamberi a.s. u ngrit në këmbë dhe derisa kaloi kufoma ai dhe shokët e tij nuk u ulën. Shokët e tij e pyetën për gjestin e tij se cili ishte shkaku që i Dërguari i All-llahut u ngrit për kufomën e hebreut? I dërguari a.s. u përgjigj duke thënë: *“Se ai ishte shpirt njeriu”*; edhe pse ishte hebre, ai duhet të respektohet si shpirt njeriu.¹⁵

Islami lufton kundër tiranisë, i mbështet të shtypurit, cilitdo popull, race apo feje që t'u përkasin ata. Pejgamberi a.s. e kujtonte pjesëmarrjen e tij në një aleancë, në mbështetje të të shtypurve dhe në vënien në vend të të drejtave të tyre, në të cilën ai kishte marrë pjesë në kohën e injorancës, duke thënë: ***“Unë në periudhën para islamit jam ftuar në një aleancë në mbështetje të të shtypurve dhe në luftë kundër agresionit. Tani, në kohën e islamit, sikur të isha ftuar në një aleancë të tillë, do të isha përgjigjur.”***¹⁶

“Deklarata islame për të drejtat e njeriut” (këto të drejta të cilat i ka vendosur Krijuesi - i Lartësuar qoftë Ai, për të cilën askush nuk ka të drejtë që t'i ndryshojë ose t'i cenojë ato të drejta). Ndër ato të drejta të cilat i proklamohen botës është edhe kjo:

Jeta e njeriut është e shenjtë dhe e pacenueshme dhe duhet bërë çdo përpjekje për ta mbrojtur atë. Në veçanti, askush nuk duhet të jetë i ekspozuar ndaj dëmtimit apo vdekjes, përveç se nën autoritetin e Ligjit islam.¹⁷

¹⁵. Salih bin Husejn El - Ajid “Të drejtat e jomyslimanëve në shtetin islam” Shkup 2005 fq. 21.

¹⁶. Ajni Sinani, “Islami ligj, kulturë dhe qytetërim” Prishtinë, 2007, f. 283.

¹⁷. Ajni Sinani vep. cit. f. 126.

HISTORIKU I MBYTJES (I VRASJES) SË NJERIUT

Vrasja si fenomen shoqëror dhe individual, shkaqet e tij kanë qenë përherë objekt interesimi që nga paraqitja e shoqërisë njerëzore. Në të gjitha formacionet shoqërore, ekonomike, që nga bijtë e pejgamberit Adem a.s. e deri te rregullimi shoqëror bashkëkohor, individët i kanë sulmuar dhe i sulmojnë vlerat e caktuara shoqërore e individuale. Sulmet ndaj vlerave të shoqërisë, duke filluar nga më e rënda - vrasje e deri te më të voglat, paraqesin një e keqe për bashkësinë njerëzore, sepse me ato çrregullohen marrëdhëniet shoqërore ekzistuese dhe me atë rast pak a shumë, vihet një pikëpyetje ekzistimi i bashkësisë shoqërore përkatëse. Sigurisht se çdo bashkësi shoqërore është mbrojtur nga sulmet e tilla shkatërruese. Vrasja si dukuri negative në shoqëri është manifestuar në forma të ndryshme gjatë historisë njerëzore. Meqenëse as bashkësia shoqërore, as individët e lënduar nuk kanë qenë indiferent ndaj sulmeve të tilla, kundër autorëve të sulmeve të tilla janë ndërmarrë masa të ndryshme reagimi. Historia e vrasjes fillon që nga fillimi i zhvillimit të njeriut të parë në këtë botë, daton me bijtë e Ademit a.s., ngjarje për të cilën më së miri na flasin vetë fjalët e All-llahut xh.sh.:

﴿وَاتْلُ عَلَيْهِمْ نَبَأَ ابْنَىٰ آدَمَ بِالْحَقِّ إِذْ قَرَّبَا قُرْبَانًا
فَتُضِلُّ مَنْ أَحَدِهِمَا وَلَمْ يُتَقَبَّلْ مِنَ الْآخَرِ قَالَ لَأَقْتُلَنَّكَ ۖ قَالَ
إِنَّمَا يَتَقَبَّلُ اللَّهُ مِنَ الْمُتَّقِينَ﴾

“Lexoju (Muhamed) atyre (hebrenjve e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbane nga të cilët njërit iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha: "Unë do të të mbys ty" (Kabili i tha Habil). E ai (që iu pranua) tha: "All-llahu pranon vetëm prej të sinqertëve." 18

Gjithashtu, All-llahu në vazhdim edhe më tej tregon për ngjarjen e bijve të Ademit a.s.:

لَيْسَ بِسَطَّتْ إِلَىٰ يَدِكَ لِتَقْتُلَنِي مَا أَنَا بِبَاسِطٍ يَدِي إِلَيْكَ
لَأَقْتُلَنَّكَ ۖ إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ رَبَّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٨﴾

“Dhe nëse ti e zgjatë te unë dorën tënde për të më mbytur, unë nuk e zgjas te ti dorën time për të të mbytur; unë i frikësohem All-llahut, Zotit të botëve!” 19

18. El Maide, 27.

19. El Maide, 28.

Pra, shohim se vrasja si fenomen negativ në shoqëri daton që nga bijtë e Ademit a.s., Kabilin dhe Habilin, siç na tregon Kur`ani fisnik për këtë ngjarje, kur Kabili njihet si kriminel i parë, ndërsa Habili njihet si sakrifica e parë në tokë. Në këtë ngjarje të bijve të Ademit a.s. dhe në bazë të shumë ajeteve kur`anore që tregojnë për këtë ngjarje, kuptojmë se vrasja daton që prej kohës së tyre, pastaj kuptojmë se në këtë rast Habili u tregua më bujar dhe më fisnik ndaj vëllait të tij kur ai e zgjati dorën për ta vrarë vëllain e vet pa asnjë lloj frike ndaj All-llahut dhe duke mos treguar dashuri dhe dhembshuri ndaj tij, në të njëjtën kohë shohim se Habili u tregua i butë dhe i sinqertë ndaj urdhrave dhe kishte frikë ndaj All-llahut fuqiptotë. Ai u shpreh ndaj vëllait duke i thënë atij se “nëse ti e zgjatë dorën tënde për të më mbytur, unë nuk e zgjas te ti dorën time për të të mbytur; unë i frikësohem All-llahut, Zotit të botëve.” Këto ishin fjalët e Habilit me rastin e grindjes mes tyre, mirëpo ai u bë kokëfortë dhe tregoi egoizëm ndaj vëllait të vet dhe e theu ligjin e All-llahut në tokë duke e mbytur atë.

Nga këto thënie kur`anore dhe nga kjo ngjarje e bijve të Ademit a.s. nxjerrim dy gjëra shumë me rëndësi: e para është se prej këtu fillon krimi i vrasjes si fenomen negativ në shoqëri dhe si një cilësi negative të cilën All-llahu e ndalon në Kur`an dhe e konsideron si mëkat të madh, një gjë që nuk ka vlerë dhe që nuk ka dobi te njerëzit në përgjithësi, e dyta është se muslimani duhet të marrë shembull nga kjo ngjarje dhe ta parandalojë veten nga kjo cilësi, të tregojë së pari frikë ndaj All-llahut fuqiptotë dhe të tregojë dashuri dhe vëllazëri ndaj njëri-tjetrit.

MBYTJA (vrasja) NË LUFTËRA DHE KONFLIKTE

Islami nuk është fe agresive, as Kur'ani e Pejgamberi a.s. nuk propagandojnë luftën apo ndonjë konflikt, përkundrazi ideali i islamit është paqja dhe siguria në jetë.

Kur'ani fisnik dhe Pejgamberi a.s. kërkojnë nga besimtarët që ta duan paqen e jo ngatërresat të cilat të çojnë deri në luftë dhe në derdhjen e gjakut. Vetë Pejgamberi a.s. gjatë shpalljes së ligjit islam e pa se lufta ishte metoda që përdorej për t'u mbrojtur vetë muslimanët, territoret dhe të drejtat e tyre.

Në lidhje me këtë, All-llahu xh.sh. thotë:

أَذِنَ لِلَّذِينَ يُقَاتِلُونَ بِأَنَّهُمْ ظَلِمُوا ۖ وَإِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ

نَصْرِهِمْ لَقَدِيرٌ ﴿٣٩﴾

"Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtë e All-llahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre (muslimanëve)."²⁰

Zbulesa kur'anore te Pejgamberi a.s. vazhdoi për një periudhë 23 vjeçare. Gjatë 13 viteve të para të kësaj periudhe, muslimanët jetonin si pakicë nën një qeverisje pagane në Mekë dhe ishin të detyruar të ballafaqoheshin me shtypje. Shumë njerëz (muslimanë) u diskriminuan, u dhunuan, u torturuan, madje edhe u vranë. Megjithatë, muslimanët vazhduan të jetojnë pa kaluar në gjakderdhje dhe gjithmonë u bënë thirrje paganëve për paqe, me të vetmin qëllim që të ruhet jeta e njeriut.

²⁰. El Haxh-xh, 39.

Kur shtypja e paganëve u bë tërësisht e padurueshme, muslimanët u shpërngulën në qytetin e Jethribit, i cili më vonë do të quhej Medinë. Aty ata do të vendosnin qeverisjen e re në një mjedis më të lirë dhe më miqësor. Edhe pse ata vendosën rendin e tyre, kjo nuk i shtyu aspak ata që të rrëmbenin armët kundër paganëve të egër të Mekës.²¹

Muhamedi a.s. i urdhëroi njerëzit e tij për luftë vetëm pasi pranoi shpalljen kur'anore:

أَذِنَ لِلَّذِينَ يُقَاتِلُونَ بِأَنَّهُمْ ظَلَمُوا ۖ وَإِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ
نَصْرِهِمْ لَقَدِيرٌ ﴿٢٦﴾ الَّذِينَ أُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بِغَيْرِ حَقٍّ إِلَّا
أَنْ يَقُولُوا رَبُّنَا اللَّهُ ۚ وَلَوْلَا دَفْعُ اللَّهِ النَّاسَ بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ
لَفَسَدَتِ الصَّوَامِعُ وَبِيعَ وَصَلَوَاتٌ وَمَسَاجِدُ يُذَكَّرُ فِيهَا اسْمُ
اللَّهِ كَثِيرًا ۚ وَلَيَنْصُرَنَّ اللَّهُ مَنْ يَنْصُرُهُ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَقَوِيٌّ
عَزِيزٌ ﴿٢٧﴾

"Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtë e All-llahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre (muslimanëve). (U lejuan të luftojnë) ata të cilët vetëm pse thanë: "All-llahu është Zoti ynë!" u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur All-llahu të mos i zmbapste disa me disa të tjerë, do

²¹. Sefijurrahman el Mubarekfuri "Nektari i vulosur i xhenetit", Prishtinë 2004.

të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut. E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues.”²²

Shkurt, muslimanët janë të lirë të luftojnë kur shtypen dhe dhunohen. Gjithashtu muslimanët urdhërohen për të mos përdorur provokime të panevojshme:

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يُقْتُلُونَكُم وَلَا تَعْتَدُوا^ج

إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ

” Dhe luftoni në rrugën e All-llahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën).”²³

Megjithatë nuk mbetet vetëm me kaq, gjatë gjithë jetës së Muhamedit shpërthyen disa luftëra, por Muhamedi a.s. krijoi një mjedis shoqëror të sigurt e paqësor për muslimanët dhe për paganët duke nënshkruar marrëveshjen e paqes, siç ishte marrëveshja e Hudejbijes. Mirëpo kjo marrëveshje nuk u zbatua. Me kalimin e kohës, ushtria muslimane arriti të krijojë një forcë të madhe kundër kundërshtarëve. Megjithatë, Muhamedi a.s. e mori Mekën nën kontroll pa gjakderdhje dhe me një shpirt të madh tolerance.

Sipas fjalëve të Xhon Esposito, ekspert përëndimor i islamit: *”...me mënjanimin e gjakmarrjes dhe plaçkitjes së pushtimit, profeti e zgjodhi çështjen duke siguruar amnistinë dhe duke mos zhveshur shpatën kundër armiqve të tij të dikurshëm.*”²⁴

²². El Haxh-xh, 39 - 40.

²³. El Bekare, 190.

²⁴. Harun Jahja, ”Isami dënon terrorizmin”, f. 41.

Jo vetëm gjatë çlirimit të Mekës, por edhe në rrjedhën e të gjitha betejave e çlirimeve të bëra në kohën e Muhamedit a.s., të drejtat e njerëzve të pambrojtur e të pafajshëm u mbrojtën me kujdesin më të madh. Muhamedi a.s. në të vërtetë iu drejtua besimtarëve që po përgatiteshin për luftë, me këto fjalë: ***"Shkoni në luftë me përkushtim ndaj fesë së Zotit! Mos prekni gratë, pleqtë dhe fëmijët, përmirësojeni gjithmonë gjendjen e tyre dhe tregohuni të butë me ta! Zoti i do njerëzit e singertë."***²⁵

I Dërguari i Zotit gjithashtu e qartësoi qëndrimin që muslimanët duhet të mbajnë edhe nëse gjenden ende në flakët e luftës apo të konflikteve: ***"Mos vritni fëmijë! Shmangni prekjen e njerëzve që ia kanë përkushtuar veten lutjes nëpër kisha! Kurrë mos vritni gra dhe pleq! Mos digjni e as mos prisni pemë! Kurrë mos rrënoni shtëpi!"***²⁶. Nga thëniet e Kur'anit dhe të Muhamedit a.s. kuptojmë se jeta e njeriut në çfarëdo rrethana që të gjendet, ajo është e sigurt dhe e garantuar nga ana e All-llahut xh.sh. dhe nuk lejohet të derdhet gjaku i tij. D.m.th. edhe në këto raste duhet të ketë kujdes njeriu që të mos i tejkalojë kufijtë e rregullave të caktuara sipas parimeve islame, mbi të drejtat e njeriut në luftëra dhe konflikte apo në ndonjë rast të ngjashëm me këto.

Sipas parimeve islame, edhe në këto raste njerëzit e pafajshëm dhe të pamundshëm siç janë fëmijët, gratë, pleqtë etj., jeta e tyre duhet të ruhet. Sipas këtyre rregullave ndalohen këto veprime në luftëra dhe konflikte: ***"Vrasjet mizore, keqtrajtimet dhe dhunimet, vrasja e grave, madje edhe kur ato i ndihmojnë meshkujt (të plagosurit), fëmijët dhe të sëmurët, vrasja e atyre që nuk mund të mbrohen siç janë pleqtë, të verbrit, të paralizuarit, të sëmurët mental dhe***

²⁵. Harun Jahja vep. cit. f. 42.

²⁶. Harun Jahja, vep. cit. f 42.

femrat, vrasja e armikut tradhtisht, sakatimi i të pafeve (pre-rja e hundës ose e veshëve), helmimi i burimeve të pijshme etj.”²⁷

Muhamedi a.s. ndërroi jetë duke lënë porositë e tij që të mos i përdorin shpatat e tyre kundër njeriut, të mos derdhet gjaku i tij në asnjë mënyrë, vetëm kur është e ligjshme. Pas vdekjes së tij vjen gjenerata e artë me të njëjtat porosi të cilat ua kishte lënë Muhamedi a.s. atyre sa ishte gjallë. Administruesit muslimanë, të cilët zbatonin me sinqeritet moralin e islamit, qeverisnin gjithmonë me tolerancë, mirësi e drejtësi. Në të njëjtën mënyrë, historia e Perandorisë Osmane që qeverisi për shekuj me radhë vende të shumta në tre kontinente, është e mbushur me shembuj tolerance dhe me kujdesin e madh për mbrojtjen e jetës së njeriut. Në këtë rast të mos lëmë pa e përmendur një shembull nga jeta e shokëve të Muhamedit a.s. thënien e artë të Ebu Bekrit r.a. kur i dha urdhër ushtrisë së tij në luftën e parë të Sirisë: ***”Ndaluni o njerëz, që të mund t’jua jap dhjetë rregulla për t’i mbajtur në mend e në zemër: Mos tradhtoni e as mos iu largoni rrugës së drejtë! Ju nuk duhet të gjymtoni, as të vrisni fëmijë, burra të moshuar apo gra...”***²⁸

Nëse shfletojmë faqet e historisë, do të shohim se ka pasur luftëra të vogla dhe të mëdha, gjithashtu do të shohim një numër të madh të vrasjeve të njerëzve të pafajshëm.

Sipas zviceranit Zhan Zhak Babel, në luftërat e deritanishme kanë humbur jetën 3 miliardë e 640 milionë njerëz.²⁹

Gjithashtu vlerësohet se vetëm në shek. XX, numri i viktimave të pafajshëm është: Prej vitit 1914 - 1918 – 10

²⁷. Vepra, revistë islame, Shkup nr. 86.

²⁸. Amër Halid, ”Përmirësimi i zemrave”, Tiranë 2005 f. 74.

²⁹. Prof.dr. Zejnullah Gruda, “Mbrojtja e të drejtave të njeriut në konflikte të armatosura”, Prishtinë 2005, f. 12.

milionë, prej vitit 1939 - 1945 – 50 milionë, prej vitit 1945 e deri më sot - 16 milionë njerëz.³⁰

Siç na është e njohur nga historia, madje edhe nga kjo e kohës më të re, ka pasur shumë shembuj të shkeljeve flagrante të rregullave më elementare të luftës.

Civilizimi modern perëndimor krenohet me deklaratën e Kombeve të Bashkuara që mbrojnë të drejtat e njeriut gjatë luftës, shpesh dëgjojmë për gaze helmuese, bomba thërrmuese dhe lloje të tjera të bombave që hidhen mbi kokat e njerëzve të pafajshëm. Mjafton këtu t'i kujtojmë vetëm disa nga veprimet barbare gjatë Luftës së Dytë Botërore, për të parë krizën e thellë morale që kishte përfshirë botën. Vetëm humbjet e njerëzve, pa i llogaritur shkatërrimet materiale, kishin përpjesëtime marramendëse. Vetëm në këtë luftë, numri i viktimave të pafajshëm ishte më se 50 milionë.³¹

Njerëzimi ka harxhuar ngjyrë sa lumenjtë e letra sa malet me dëshirë të flaktë për paqe.

Pas Luftës së Dytë Botërore, më 26 qershor të vitit 1945 në San Francisko pesëdhjetë shtete e nënshkruan Kartën e Kombeve të Bashkuara. Pjesa hyrëse e saj fillon me moton: *"Ne, njerëzit e Kombeve të Bashkuara, kemi vendosur t'i mbrojmë gjeneratat e ardhshme prej tragjedisë së luftës e cila dy herë në distancë prej një gjenerate, i solli njerëzisë mjerime të papërshkrueshme."*³²

Pas nënshkrimit të kësaj karte, pjesa dërmuese e njerëzve menduan se një dokument i këtillë kurrë deri atëherë nuk ka qenë i formuluar. Ndërkaq, shumica e tyre kanë pritur se do të bëhet kthesë në historinë e civilizimit. Për fat të keq,

³⁰. Nikola M. Nikolov, "Komploti botëror", Tetovë 1998, f. 27.

³¹. Shih prof. dr. Zejnullah Gruda "Mbrotja e të drejtave të njeriut në konflikte të armatosura", Prishtinë 2005.

³². Nikola M. Nikolov, vep. cit. f. 32.

pas shumë pritjeve të mëdha, dëshpërimi bëhet edhe më i madh.

Edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të zhvillohen luftëra të tmerrshme. Prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, më shumë se 25 milionë njerëz janë vrarë në më se 150 luftëra. Çdo ditë diku në botë zhvillohen mesatarisht rreth 14 luftëra të ndryshme.³³

Volteri në një shkrim shprehet: *"E kuptoj perfekt të drejtën e paqes; kjo e drejtë nënkupton mbajtjen e fjalës për t'i siguruar çdo njeriu të gëzojë plotësisht të drejtat e tij natyrore, mirëpo nuk di ç'është e drejta e luftës. Një kodeks për vrasje më duket një konceptcion i çuditshëm."*³⁴

Gjithashtu, Montaigne ka thënë: *"Në esencë, kjo shkençë ose art për të vrarë, për të shkatërruar dhe për të zhdukur llojin e vet është gjendje që nuk e bëjnë as egërsirat."*³⁵

Jemi dëshmitarë të kohës në të cilën po jetojmë, çdokush ka dëgjuar dhe dëgjon vrasje dhe masakra që kryhen në njeriun gati në të gjithë botën. Për të mos lënë pa e cekur Irakun e sotëm të larë me gjak, djepin e dikurshëm të diturisë, çdo ditë vriten me dhjetëra njerëz të pafajshëm, pastaj lufta në Çeçeni e lënë në harresë ku aty nuk ndalen vrasjet çdo ditë, në Bosnjë e Hercegovinë ku ndodhi një masakër marramendëse e cila do të mbahet në mend gjithmonë. Gjithashtu së fundi edhe në Kosovë. Sipas KMDLNJ, ka indikacione shumë të sigurta se një pjesë e viktimave shqiptare janë djegur në furrat e shkrites së minierës së Trepçës. Të vrarët e të masakruarit u hodhën edhe nëpër puse të ujit

³³. Nikola M. Nikolov, vep. cit. f. 33.

³⁴. Prof. dr. Zejnullah Gruda, vep. cit. f. 11.

³⁵. Prof. dr. Zejnullah Gruda, vep. cit. f. 11.

nëpër fshatra, një numër i tyre mbetën me javë e me muaj të pavarrosur. Numri i të vvarëve besohet të jetë mbi 11.000.³⁶

Muhamedi a.s. erdhi me moton e tij që t'i sjellë njerëzisë paqe dhe siguri dhe çdokush ta jetojë jetën e tij kudo që gjendet dhe kudo që jeton. Ai e la porosinë para 14 shekujve, duke i porositur të gjithë njerëzit pa dallim: *"...mos të kërkojnë konflikt me armikun."* Por, në raste lufte dhe konflikte, ai e la porosinë e tij me sa vijon: *"Kur të shkoni në luftë, bëjeni këtë në emër të Tij dhe për hir të Tij. Mos i kaloni kufijtë, mos i thyeni premtimet dhe mos vritni fëmijë."*³⁷

Muhamedi a.s. gjithashtu la porosinë që në raste kur zënë robër:

استو صوابا لأسارى خيرا

"Ju porosis që të silleni mirë me robërit eluftës".³⁸

Në islam gjithashtu ndalohet eksperimentimi me robërit, fyerja apo torturimi i tyre. E njëjta ndalesë zbatohet për robërit e plagosur.

Haptazi mund të them se asnjë fe nuk kujdeset për të drejtat e njeriut për jetë më shumë se islami dhe askush nuk i zbaton të drejtat e njeriut më shumë se muslimanët, për këtë dëshmon vetë historia dhe koha në të cilën jetojmë. Kjo ka ndodhur gjithnjë në të kaluarën dhe ndodh në të tashmen, e sigurisht do të ndodh kështu në të ardhmen nëse islamit dhe parimet e tij i kanë në zemër.

³⁶. Dr. Vesel Latifi. "Kriminalistika", Prishtinë 2001, f. 145.

³⁷. Takvimi 2006, nr. 36 Prishtinë, f. 195.

³⁸. Takvimi vep. cit. f. 196.

MBYTJA (vrasja) NË TRADITA DHE ZAKONE

Me vrasje sipas të drejtës zakonore kuptohet ajo vepër që ia privonte jetën personit tjetër, e kryer me faj dhe e parashikuar nga normat penale të së drejtës zakonore të mbledhura në kanune.³⁹

Në këto vende pasi nuk kishte shtet të organizuar, nuk ka dyshim që roli i normave të saj (të drejtës zakonore) në mbrojtje të personit ishte pozitiv, sepse ia priste rrugën arbitraritetit, dhunës, vrasjeve pa kufi etj. Ato norma marrin nën mbrojtje jetën e personit që nga lindja e tij.

Sipas të drejtës zakonore penale, vrasja mund të kryhej me veprime aktive dhe me mosveprime (me porosi, direkt dhe indirekt). Materialet e grumbulluara në kanune deshmojnë se shumica e madhe e vrasjeve kryhej me veprime aktive, duke përdorur mjete të ndryshme, sidomos pushkën.

Vrasja për t'u quajtur krim për t'u dënuar, duhet të parashikohet nga e drejta zakonore penale si vepër që binte në kundërshtim me normat e saj.

Veçoria e së drejtës zakonore penale është se ajo njeh edhe vrasje të padënueshme si p.sh. vrasja e fëmijës nga babai, vrasja e gruas në marrëdhënie seksuale bashkë me personin me të cilin kryente aktin seksual, vrasja ndërmjet njëri-tjetrit - krye për krye, gjak për gjak etj.

Për krimin e vrasjes mund të përgjigjej cildo burrë që ishte i aftë për të mbajtur armë (rreth moshës 14-15 vjet). Gruaja në çdo rast nuk kishte përgjegjësi penale, sepse ajo nuk mbante armë, për vrasjen që ajo mund ta kryente përgjigjej prindi i saj, sipas parimit: “Gruaja s’bien në gjak” sepse botë-

³⁹. Prof. dr. Ismet Elezi, “Njohuri për të drejtën zakonore mbarëshqiptare”, Prishtinë 2003, f. 93.

kuptimi fisnor patriarkal gruan e konsideron si e huaj në familje.⁴⁰

Vrasja kryhej me dashje (me qëllim) dhe nga pakujdesia, kështu edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit dallohen këto forma të fajit: Paramendimi dhe Pakujdesia.

Llojet e vrasjeve:

1) Vrasjet që drejtohen kundër jetës së një personi.

Pavarësisht se cili është motivi i kësaj vrasje.

2) Vrasjet që drejtohen kundër jetës së disa personave.

Ky lloj më shumë ka ndodhur nëpër dasma, p.sh. kur takoheshin dy grupe krushqish në rrugë (dhe rrugët ishin të ngushta sa për një karrocë), ata nuk ia lëshonin rrugën njëritjetrit dhe kjo ndodhte sepse kjo konsiderohej nënçmim dhe dobësi për palën që lëshonte rrugë dhe fillonin të gjuanin me pushkë dhe ndodhnin vrasjet e disa personave (krushqve).

Shembuj të këtillë kemi mjaft. Rasti më i freskët është vrasja e dy vëllezërve për hakmarrje në Komunën e Gjakovës (qytet në Kosovë) në mars të vitit 2004, siç kanë njoftuar mediumet elektronike dhe të shkruara të datës 19 mars 2004.

*Vrasja për kufij, toka, dhe kullosa.*⁴¹ Ky lloj i vrasjes ekziston aty-këtu edhe sot e kësaj dite, sidomos nëpër fshatra. Këto fillojnë me grindje e shpeshherë përfundojnë me vrasje. Këtu vrasjet bëheshin për shkak të luajtjes së gurit i cili ka qenë dhe është për ndarjen e pronave, tokave dhe kullosave. Vrasja e këtillë sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dënohej me vdekje, grihej katundisht (pushkatohej nga i gjithë katundi ose prehej me shpatë apo sëpatë etj.) dhe paguhej gjoba me 100 desh dhe 1 ka. (KLD 251).

⁴⁰. Prof. dr. Ismet Elezi, vep. cit. f. 94.

⁴¹. Prof Dr. Ismet Elezi “Njohuri për të drejtën zakonore mbarëshqiptare” Prishtinë 2003 fq, 95

*Vrasjet për grabitje ose rrëmbim grash.*⁴² Ky fenomen ka qenë i njohur në të kaluarën te shqiptarët ku ndodhte që të grabitet vajza ndoshta edhe pa dëshirën e saj dhe të merret në shtëpi për grua. Pastaj familja e vajzës e nënçmuar me këtë, detyrohej ta merrte vajzën e tyre dhe këtu fillonte problemi dhe shpesh përfundonte me vrasje. Kjo ndodh edhe në ditët e sotme aty-këtu, por vajza ikë vetë nga shtëpia e babait në shtëpinë e burrit dhe këto raste nuk sjellin vrasje. Por pas një kohe pajtohen familjet dhe të rralla janë ato familje që nuk janë pajtuar kurrë me bijën e tyre.

*Vrasja e personave të mbrojtur ose në besë.*⁴³ Vrasja që drejtohej kundër një personi që ishte nën besën e një familje, fisi ose katundi, me këtë prekeshin marrëdhëniet shoqërore. Me këtë lloj të besës, siguroheshin netët e personit të caktuar të mbrojtur posaçërisht nga normat penale të kanunit.⁴⁴

*Vrasja për gjakmarrje.*⁴⁵ Gjakmarrja si rregull kryhej botërisht dhe haptazi, kështu që dihej dorasi dhe sipas kanunit, neni 844, dorasi duhet t'i çojë fjalë se ai e vrau dhe të mos habiten prindërit e të vërrit. Por ato kryheshin edhe fshehurazi, edhe pse ky konsiderohet veprim i turpshëm. Me rastin e kryerjes së vrasjes ose gjakmarrjes, dorasit i ndalohej ta masakrojnë viktimën, sepse kjo dënohej me të drejtën zakonore dhe vrasësi konsiderohej dy herë fajtor dhe ngarkohej me dy gjaqe. Pastaj, dorasi sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit nuk guxon t'ia marrë armën të vërrit, sepse ai me këtë vepër vjen në dy gjyqe. (KLD, 847).

⁴². Prof Dr. Ismet Elezi op, cit, fq, 95

⁴³. Prof Dr. Ismet Elezi op, cit, fq, 95

⁴⁴. Si vrasje e cilësuar quhet vrasja e klerikut (hoxha dhe prifti) e cila si rregull dënohej me vdekje. Shih më gjerësisht te prof. dr. Ismet Elezi, "Njohuri për të drejtën zakonore mbarëshqiptare", Prishtinë 2003 f. 95.

⁴⁵. Prof Dr. Ismet Elezi op, cit, fq, 100, 101

Ka edhe shumë lloje të vrasjeve, *vrasja për marrëdhënie të dhunshme seksuale dhe vrasja e gruas në punë të liga me gjithë partnerin, vrasjet në gjendje të dehur nga alkooli, vrasjet në gjendje të papërgjegjshme, vrasjet e provokuara nga agresioni*.⁴⁶ Sipas rezultateve të hulumtimit tonë, vetë viktimat pak ose shumë me sjelljet e tij ka kontribuar që të vritet. Kjo ka ngjarë gati në gjysmën e rasteve të vrasjeve të kryera (rreth 47%) në periudhën 10 vjeçare.⁴⁷

Kështu sipas hulumtimeve, prej gjithsej 211 kryerësve të vrasjeve, në Gjykatat e Kosovës, 100 vrasje ose 47% kanë qenë të provokuara me sjellje apo veprime të ndryshme të viktimës.

Vrasjet enigmatike (vrasjet të cilave nuk u dihen motivet ose vetëm dyshohet për motivet, ku autori mbetet i pazbuluar për një kohë ose përgjithmonë).⁴⁸ Ky lloj i vrasjeve gjendet kudo në botë, por në Kosovë është një fenomen mjaft i përhapur, sepse kanë ndodhur vrasje të shumta prej kohës së pasluftës dhe së paku për opinionin në media ose diku tjetër, asnjëherë deri tash nuk janë zbuluar vrasësit ose motivet e vrasjes nga organet kompetente.

Akuza të shumta janë drejtuar në adresë të personave të ndryshëm të partive politike, të institucioneve të ndryshme brenda e jashtë Kosovës, të cilat janë publikuar nëpër gazeta të ndryshme, por asnjëherë (për shumicën e këtyre rasteve) zyrtarisht nuk është kapur asnjë person dhe nuk është zbuluar zyrtarisht motivi i vrasjes, edhe pse në Kosovë ekzistojnë forca të mëdha ushtarake të KFOR-it, gjithashtu edhe numër i madh i policëve profesionistë ndërkombëtarë të UNMIK-ut, ku edhe numri i policëve të vendit tani ka arritur

⁴⁶. Fejzulla Hasani “Vepra penale, vrasja në afekt” punim magjistrature Prishtinë 1999

⁴⁷. Dr. Ismet Salihu- Vrasjet në Kosovë, f. 205.

⁴⁸. Fejzulla Hasani “Vepra penale, vrasja në afekt” op, cit.

në 6000 policë, megjithatë vrasjet nuk janë ndalur dhe nuk kanë të ndalur, ndonjëherë më shumë e ndonjëherë më pak.

Në Konferencën Ndërkombëtare të mbajtur më 12-13 dhjetor 2002 në Tiranë me titull “Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen me të” (kryesisht këto vende të banuara me shqiptarë), me ç’rast nga punimet e kësaj konference u botua një libër i veçantë, nga ligjëruesit potencohet se edhe në Kosovë ekziston krimi i organizuar. Në fjalën hyrëse, dr. Shefki Bejko ishte shprehur se krimi i organizuar është kthyer aktualisht në një rrezik serioz për vendet e sipër përmendura dhe se ky fenomen kriminal shprehet me vrasje, me trafikim të drogës, me prostitucion, me keqpërdorim të fëmijëve, me korrupsion etj. Faktorët kryesorë që ndikojnë në praninë dhe në rritjen e krimit të organizuar janë mungesa e stabilitetit politik, luftërat, varfëria e këtij rajoni, problemet etnike, diferencat apo vakumet ligjore dhe administrative etj.

*Vrasjet Etnike.*⁴⁹ Vrasjet etnike njihen te ata popuj të cilën kanë krijuar urrejtje të shumta mes vete, qoftë në kohët e tashme apo nga e kaluara dhe këto më tepër shfaqen mes popujve në një shtet ose mes shteteve fqinje. Këto vrasje kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në tërë botën, por Ballkani është më i njohur për këtë lloj të vrasjeve. Mund të thuhet se numri i vrasjeve kohët e fundit në Kosovë, duke përfshirë edhe luftën e vitit 1999, më së tepërmi janë bërë për vrasje etnike. Vrasjet etnike mund të jenë të rastit dhe të paramenduara, pas ndonjë provokimi negativ që e kryen ndonjëra prej palëve, siç është rasti i 17 marsit 2004, ku tre fëmijë shqiptarë gjetën vdekjen me ç’rast u akuzuan serbët se janë shkaktarë të këtyre vdekjeve e pastaj shqiptarët i sulmuan serbët.

⁴⁹. Dr. Ismet Salihu “Vrasjet në Kosovë” Prishtinë 1985

*Vrasja në afekt (gabimisht ose nga pakujdesia).*⁵⁰ Ky lloj i vrasjeve është mjaft i njohur jo vetëm te shqiptarët në Kosovë, por anë e mbanë botës si në kohët e vjetra të kaluara, gjithashtu edhe në kohët e sotme. Vrasja gabimisht ose në afekt konsiderohet çdo vrasje që kryerësi pa faj dhe pa dëshirën e tij të ketë rënë në gjendje të këtillë.⁵¹

P.sh. kur godet pa qëllim ose godet për shkak të sulmit ose fyerjes së rëndë nga ana e viktimës, menjëherë pas sulmit. Kryesisht vrasja ndodh pa pasur qëllim dorasi që të vrasë. Ka edhe disa lloje të vrasjeve, por mendoj se mjafton vetëm me këto.

Dihet se ky fenomen negativ (vrasja), është krim që duhet të luftohet dhe duhet të eliminohet te çdo popull, shoqëri etj., për shkak të dëmeve që i sjell ajo. Edhe në të drejtën zakonore ky krim i rëndë është njohur si vepër shumë e rëndë dhe jo e pëlqyer në popull. Të gjitha shoqëritë qysh nga fillimi i kësaj bote e deri sot pajtohen se vrasja me qëllim është krim më i urryer te njerëzit, e cila kurrë nuk ka pasur mbështetje fetare, as ligjore dhe as mbështetje dhe përkrahje zakonore.

Mbi gjithë këtë, krimi i vrasjes është edhe kërcënim, çrregullim, shkatërrim dhe humbje e sigurisë në atë shoqëri. Për shkak të natyrës së saj shkatërruese, krimi i vrasjes përhërë ka zgjuar frikë, pasiguri dhe tmerr ndër qytetarët duke shtuar në të njëjtën kohë interesimin për të Prandaj, në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore është shprehur një interesim i veçantë për shkakun, natyrën dhe motivet e krimin si edhe për pasojat tragjike, mënyrën dhe dënimin e tij.

⁵⁰. Fejzulla Hasani “Vepra penale, vrasja në afekt” op, cit.

⁵¹. Fejzulla Hasani “Vepra penale, vrasja në afekt” punim magjistrature, Prishtinë 1999.

KAPITULLI I DYTË

MBYTJA (vrasja) NË ISLAM

» VLERA E NJERIUT NË ISLAM

» MBYTJA (vrasja) E NJERIUT PA TË DREJTË NË ISLAM ËSHTË E NDALUAR DHE ËSHTË KRIM, GJYNAH (MËKAT)

» VETËDIJA FETARE DHE NDIKIMI I SAJ NË PENGIMIN E MBYTJES (vrasjes)

» ISLAMI NDËSHKON MBYTËSIN (vrasësin)

VLERA E NJERIUT NË ISLAM

Muslimani duhet të ketë njohuri për të vërtetat që kanë të bëjnë me njeriun dhe me realitetin e tij. Ai këto të vërteta që do t'i përmendim duhet t'i besojë me bindje të plotë dhe pastaj mbi këto të ngrejë arsyen e besimit të vet.

Njeriu ndër gjithë krijesat është më i vlefshmi dhe më i nderuari.

Njeriu është i krijuar që nga zanafilla e parë në pamje dhe në formën më të bukur, ai nuk ka evoluar gjatë historisë së tij për nga gjinia prej një shkalle në shkallën tjetër.

Njeriu është krijesa më e vlefshme dhe më fisnike

Njeriu dallohet nga krijesat e tjera me veçori që ia dha Zoti si krijues absolut. Natyra njerëzore dallohet nga natyrat dhe ekzistencat e tjera me fuqinë e jashtëzakonshme, mahnitëse e të çuditshme, e që është forca mendore, e cila përcepton realitetin e gjërave dhe e cila është edhe çelësi i parë që shumica e fenomeneve të gjithësisë të vihen nën shërbimin dhe nën pushtetin e njeriut. Këtë dallim (privilegj) të njeriut, shumë doktrina, filozofi, shkolla dhe dijetarë, të lëmimeve të ndryshme e theksuan dhe e pranuan, por një pakicë prej tyre e dinin burimin e kësaj vlere, dhe nuk e pranuan dhe kanë mendime të kundërta për njeriun. Islami është i vetmi që tha se njeriu është zëvendës apo rimëkëmbës i All-llahut xh.sh në Tokë, këtë vlerë nuk ia veshi njeriut asnjë doktrinë, edhe pse ato u munduan të thonë mbi njeriun gjara shumë pozitive, por më të rëndësishmët nuk u thanë asnjëherë. Për këtë All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلٰٓئِكَةِ اِنِّىْ جَاعِلٌ فِى الْاَرْضِ خَلِيْفَةً ۚ

**“ (Përkujto Muhammed) Kur Zoti yt u tha engjëjve:
"Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!"⁵²**

Pra në kuadër të Kur'anit Krijuesi i dha njeriut rolin më të shëjtë, të zëvendësor apo të rimëkëmbë ligjin e All-llahut xh.sh.

Prej veçorive (karakteristikave) të kësaj fuqie mendore është se kjo është një fuqi ku në të shfaqet drita e njohjes së All-llahut Fuqiplotë dhe nga ajo rrezaton drita e Madhëris së Tij, si dhe me të zotëruesi i saj përgaditet që të kryej adhurin ndaj krijesit të Vet, të Madhërishëm e Fuqiplotë. Kështu që si rrjedhojë e kësaj njeriu behet dukuria e parë e Hyjnisë së All-llahut Fuqiplotë.

Pasi kjo është kështu atëherë prej domosdoshmërive të qarta është që natyra njerëzore të jetë më fisnikja dhe më bujaria ndër të gjitha ekzistenca në gjithësi (nëse mbështetja përjashtimin e melaikeve, duke patur parasysh konsideratat e veçanta lidhur me to).

Çështja që ka të bëjë me at që e shohim nga prova dhe eksperimenti, e që flet për vërtetësinë e argumenteve të fjalës së All-llahut Fuqiplotë ku thotë:

وَسَخَّرَ لَكُم مَّا فِى السَّمٰوٰتِ وَمَا فِى الْاَرْضِ جَمِیْعًا مِّنْهُ ۚ

اِنَّ فِىْ ذٰلِكَ لَاٰیٰتٍ لِّقَوْمٍ یَّتَفَكَّرُوْنَ ﴿١٢٠﴾

“Dhe për ju nënshtroi gjithë ç'ka në qie dhe ç'ka në tokë, njëmend për njerëzit që mendojnë thellë, në to ekzistojnë argumente”⁵³

⁵². El Bekare 30

Pra, ti sheh se e gjithë lëvizja e trupave qiellorë, sistemi i gjithësisë dhe një pjesë e qenieve (ekzistencave) të ndryshme, të gjitha këto lëvizin në përputhje me nevojën dhe shërbimin e njeriut. Pra, njeriu në këtë ekzistencë paraqet rrethin polar, që është rrethi i tijë, ku në drejtim të tij lëvizin ekzistenca të tjera të ndryshme, në një vijë qarkulluese (udhëtim) të vazhdueshme e të pa ndërprerë, që njeriut t'i ofrohen (strukturohen) elementet e jetesës më të volitshme dhe t'i ofrojnë atij elementet e domosdoshme dhe nevojat e ndryshme të tij.

Prej kërkesave të atyre që përmendëm, është që kjo krijesë që e ka këtë pozitë ndaj ekzistencave të tjera dhe ekzistencat tjera ndaj tij, është që ky të jetë më i vlefshmi dhe me fisniku në përgjithësi.

Çështja tjetër është vetitë me të cilat All-llahu Fuqiplotë e pajisi njeriun në përgjithësi janë begati nga cilësitë e All-llahut (hyjnisë së Tij), si dituria, fuqia, madhëria, të paturit prirje për dominim, sundim dhe pushtet etj....

Pasiqë në faktë, njeriu është depoja e hijeve dhe e rrezatimeve të cilësive të Zotit të Madhërishëm, atëherë sa i përshtatshëm dhe i denjë që është njeriu që të jetë më i vlefshëm dhe më fisniku ndër të gjitha krijesat. Thënë shkurt, vlefshmëria e njeriut ndaj të gjitha krijesave (me përjashtim të melaikeve) është një e vërtetë e pakundërshtueshme, për të cilën dëshmon lajmi i vërtetë dhe argumenti racional i shëndoshë, prandaj çdo njeri e ka të detyrueshme që një gjë të till ta besoj.

Njeriu që nga fillimi i ekzistencës është i krijuar në pamjen më të përsosur dhe formën më të bukur. All-llahu xh. Sh në Kur'an thotë:

⁵³. El Xhathije 13

لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ ﴿٤٥﴾

“Vërtet, Ne e krijuam njerin në formën më të bukur”.⁵⁴

Pra, nyja shquese “el” te fjala “el - insan” është shquarje e klasës (llojit) si tërësi në mënyr të përgjithësuar, gjë që është e njohur mirë ku kjo tregon se këtu përfshihen të gjithë individët.⁵⁵

E ngjashme me këtë është edhe fjala e All-llahut Fuqiplotë ku thotë:

يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ مَا غَرَّكَ بِرَبِّكَ الْكَرِيمِ ﴿٥٠﴾ الَّذِي

خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ فَعَدَلَكَ ﴿٥١﴾

“O ti njeri, po ç'të mashtror ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë? I cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi”.⁵⁶

Prej gjërave të konfirmuese në Sahihajnët nga Ebu Hurejre, All-llahu qoft i kënaqur me të, se i Dërguari i All-llahut a.s ka thënë:

“All-llahu Ademin e krijoi në formën që Ai e ka.....”, d.m.th., që kur All-llahu e krijoj Ademin, forma e tij ka qenë po kjo që ka tani, e cila ka vazhduar dhe është i njohur me të. Kjo na jep të kuptojmë se ai nuk është krijuar duke kaluar prej një forme në tjetrën. Pra, përemri “ai” i kthehet “Ademit”. Po ashtu ka edhe një mendim tjetër që thotë se

⁵⁴. Et Tin 4

⁵⁵. Prof. Dr. Muhamed seid Ramadan el - Buti “Të vërtetat e patundshme të besimit islam” Tetovë 2004 fq, 251

⁵⁶. El Infitar 6 - 7

përemri kthehet te “*All-llahu*” Fuqiplotë kurse domethënia e fjalës “*forma*” është “*cilësia*”, d.m.th, All-llahu njeriun e krijoi të dijshëm, të vullnetshëm, të urtë, që dëgjon, që sheh....., të cilat janë cilësit e All-llahut Fuqiplotë.⁵⁷

Ndërkaq pa marrë parasysh përemrin, a e kthejm tek “*Ademi*” që është mendimi i masës dërmuese të dijetarëve dhe për të cilin edhe kuptimi i dukshëm i Hadithit dëshmon, apo e kthejmë përemrin tek “*All-llahu*”, hadithi vërteton domethënien definitive, të prerë që është në Kur`an, sepse biseda këtu është për të sqaruar nderimin që idha All-llahu Fuqiplotë, Ademit që nga filimi i krijimit të tij.

Këto vlera e shumë të tjera islami përsëri është i vetmi që me ligj mbronë vlerat njerëzore, mbronë kulturën dhe civilizimin njerëzorë, studion dhe jep mesagje humane, përhap dashuri dhe respekt, nderon pozicionin e njeriut si krijes e dalluar.

Nga e gjithë kjo kuptojmë se njeriu është krijesa më e vlefshme që ka krijuar All-llahu dhe nderin që ia ka bër atij.

⁵⁷. Prof. Dr. Muhamed seid Ramadan el - Buti op, cit, fq, 252

MBYTJA (vrasja) E NJERIUT PA TË DREJTË NË ISLAM ËSHTË E NDALUAR DHE ËSHTË KRIM, GJYNAH (MËKAT)

Islami e ka shenjtëruar jetën e njeriut dhe ka ndaluar mbytjen e tij përveç kur ai shkakton ndonjë dëm në tokë. Nuk lejohet kurrfarë kërcënimi i të drejtës së njeriut për jetë, duhet të vihet në jetë parimi humanitetit, dëshira e njeriut për të jetuar, pa marrë parasysh se çfarë pozite ka, prandaj pa marrë parasysh shkakun dhe çastin që e detyron, jeta e njeriut nuk duhet të shuhet përveç se në raste të parashikuar nga All-llahu i lartësuar. All-llahu xh.sh. në lidhje me këtë, thotë:

وَالَّذِينَ لَا يَدْعُونَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ وَلَا يَقْتُلُونَ

الْنَفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَا يَزْنُونَ

“Edhe ata që pos All-llahut nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë.”⁵⁸

Nuk duhet të rrezikohen as pasuria, as nderi, as liria, as autoriteti dhe asnjë e drejtë tjetër e njeriut. Islami reptehtësisht e ka ndaluar mizorinë, format dhe mënyrat e saj, pa marrë parasysh rrethanat dhe shkaqet. Muslimani në shoqërinë islame gjakun e ka të mbrojtur dhe se ndalohet ky gjak të derdhet. Pejgamberi a.s. ka thënë:

قتل المؤمن أعظم عند الله من زوال الدنيا

“Mbytja e besimtarit konsiderohet mëkat më i madh se sa shkatërrimi i gjithë kësaj bote.”⁵⁹

⁵⁸. El Furkan 68.

Ajetin të cilin e cituam më lartë: “...vetëm kur e mëriton në bazë të drejtësisë”, nënkupton dënimin për tre krime.

1. Vrasja e padrejtë (pa faj):

Për secilin që argumentohet krimi i vrasjes, obligohet shpagimi shpirt për shpirt dhe e keqja për të keqe, ngase iniciatori është shkaktar i këtij dëmi:

All-llahu xh.sh. në lidhje me këtë thotë:

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيَوةٌ يَتَأُولَىٰ الْأَلْبَبِ لَعَلَّكُمْ

تَتَّقُونَ ﴿١٧٩﴾

“O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri-tjetrit).”⁶⁰

2. Kurvëria (amoraliteti) publike e personit dhe e dëshmuar nga katër dëshmitarë të njerëzve të besueshëm. Dënimi me vdekje lejohet në qoftë se pushti e lavirja janë të martuar. Dëshmia individuale e katërfishtë para gjykatësit është e barabartë me dëshminë e katër dëshmitarëve.

3. Dalja nga islami pas pranimit të tij me qëllim që t'i kërcënohet xhematit islam.

Islami nuk e obligon askënd që me dhunë të hyjë në të, por në të njëjtën kohë refuzon manipulimin me fenë. Pejgamberi a.s. në lidhje me këto tri komponentë thotë:

⁵⁹. Sunen et -Tirmidhij, Ed - dijat, v. 5, f. 82.

⁶⁰. El Bekare, 179.

لا يحل دم امرئ مسلم يشهد أن لا إله إلا الله و أني رسول الله إلا بأحدى ثلاث الشيب الزاني و النفس بألنفس و التارك لدينه

“Nuk lejohet të derdhet gjaku i muslimanit, që dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut dhe se unë jam i dërguari i All-llahut, përveç se në njërin prej tri rasteve: Ai që është martuar por ende bën prostitucion, ai që mbyt njeri, ai që braktis fenë e vet dhe ndahet prej turmës.”⁶¹

Përgjegjësinë e përmbarimit të këtyre vendimeve e ka shteti islam i cili nuk duhet të lejojë që kjo përgjegjësi të bartet te individi, as të gjykojë e as të ekzekutojë individi, sepse një gjë e tillë do të shkaktonte çrregullime dhe kaos të madh në shoqërinë islame. Vetëm në rastin e vrasjes së qëllimtë që shpaguehet me marrjen e gjakut, islami e lejon që të afërmit të bëhen ekzekutues në praninë e personit autoritar, me qëllim që të qetësohen shpirtat e tyre dhe të shuhet zjarri gjakmarrjes. Në këtë kontekst, All-llahu xh.sh. thotë:

وَلَا تَقْتُلُوا النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَمَنْ قَتَلَ مَظْلُومًا فَقَدْ جَعَلْنَا لَوْلِيهِ سُلْطٰنًا فَلَا يُسْرِفُ فِي الْقَتْلِ

إِنَّهُ كَانَ مَنْصُورًا ﴿١٢٧﴾

“Dhe mos e mbytni njeriun që All-llahu e ka ndaluar (mbytjen e tij), përveç me drejtësi (që e kërkon sheriatin). E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij Ne ia

⁶¹. Fet`hul Bari, vëll. 15, f. 222. Sahihul Muslim, vëll. 3, f. 1302 nr. 1676.

kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë) e ai të mos e kalojë kufirin në mbytyje derisa ai është i ndihmuar (prej Zotit)."⁶²

Çka nënkuptojmë prej këtyre citateve kur'anore dhe thënieve të Pejgamberit a.s.? Ne kuptojmë se në rend të parë nuk lejohet të cenohet e drejta e njeriut për jetë, për arsye se All-llahu është shkaktar i ardhjes së tij në tokë dhe se vetëm Ai jep dhe merr jetë dhe nuk i lejohet askujt që të ngritë dorën kundër vëllait të tij që ta mbysë. Pastaj një gjë të tillë All-llahu xh.sh. e ka konsideruar krim kundër njerëzimit për të cilën e pret një dënim i madh në botën tjetër. Pastaj, Pejgamberi a.s. vrasjen e njeriut e ka renditur në mëkatet e mëdha pas shirkut.

Islami në fushën e të drejtave të njeriut - e drejta për jetë, është më i avancuar dhe mbizotëron, mbi të gjitha fetë, teoritë dhe drejtimet. Në lidhje me këtë, All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

مِنْ أَجْلِ ذَٰلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَءِيلَ أَنَّهُ مَن قَتَلَ
نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ
جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا

"Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush mbyty një njeri (pa të drejtë), pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur

⁶². El Isra ajeti, 33.

të gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është sikur t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit." ⁶³

Ky ajet tregon se kërcënimi i jetës së njeriut konsiderohet kërcënim i të drejtës për jetë të të gjithë njerëzve. Pra është krim që prek mbarë botën në të drejtën për jetesë.

Bejzaviu (komentues i Kur'anit) thotë se me këtë ajet, Zoti ka për qëllim ruajtjen e njerëzve nga vrasja që është krim tepër i madh dhe ndëshkimi për vrasësin është shumë i rëndë. ⁶⁴

Përkufizimi i përgjithshëm i jetës nënkupton se ajo është dhunti e All-llahut xh.sh. dhuruar krijesës së tij – njeriut, prandaj askush nuk është kompetent për marrjen apo mohimin e saj, veçse me të drejtë të përcaktuar. Jeta është e drejtë kolektive e të gjithëve. All-llahu xh.sh. lidhur me këtë thotë:

وَإِنَّا لَنَحْنُ نُحْيِي ۖ وَنُمِيتُ وَخُنُ الْوَارِثُونَ

“Ne, vërtet jemi që japim jetë e vdekje dhe Ne jemi trashëgues (të qiejve e tokës).” ⁶⁵

Mbytja e njeriut pa të drejtë, në islam konsiderohet krim por konsiderohet edhe prej mëkateve të mëdha.

I Dërguari s.a.v.s. shumë mirë e ka sqaruar se mbytja e njeriut pa të drejtë ligjore, është një nga shtatë mëkatet e mëdha që shkatërrojnë qenien njerëzore. Ai ka thënë:

اجْتَنِبُوا السَّبْعَ الْمُوبِقَاتِ قَالُوا يَا رَسُولَ اللَّهِ وَمَا هُنَّ قَالَ الشِّرْكُ بِاللَّهِ وَالسَّحَرُ وَقَتْلُ النَّفْسِ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ

⁶³. El Maide, 32.

⁶⁴. H. Hafiz Ibrahim Dalliu, “Ajka e kuptimeve të Kur’ani kerimit”, Tiranë 2005, f. 587.

⁶⁵. El Hixhr, 23.

“Largohu prej shtatë mëkateve shkatërruese.” Ata thanë: “O i Dërguari i All-llahut, cilat janë ato?” Ai tha: “Politeizmi (shirku), magjia, mbytja e njeriut që e ka ndaluar All-llahu, përveç sipas të drejtës ligjore.....”⁶⁶

Mëkati nuk vlen vetëm për vrasësin, por edhe për çdo pjesëmarrës në vrasje. qoftë me fjalë ose me vepra, pjesëmarrësi dënohet nga Zoti sipas asaj se sa ka qenë aktiv në aktin e tillë, bile edhe ai që prezanton në vrasje merr një pjesë të mëkatit. Në një hadith, Pejgamberi a.s. ka thënë: ***“Le të mos qëndrojnë ndokush prej jush në vendin ku vritet pa të drejtë ndonjë njeri. Mallkohet ai që prezanton e që nuk e mbron!”***⁶⁷

⁶⁶. Sahihul Buhari, vëll. 3, f. 159; Sahihul Muslim, vëll. 1, f. 277.

⁶⁷. Transmeton Taberaniu dhe Bejheku.

VETËDIJA FETARE DHE NDIKIMI I SAJ NË PENGIMIN E MBYTJES (vrasjes)

Feja është interes i domosdoshëm për botën njerëzore, sepse ajo është sistem që rregullon marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe krijesit të tij, marrëdhëniet e ndërsjella njerëzore, marrëdhëniet midis personit dhe shoqërisë dhe anasjelltas dhe marrëdhëniet e vetë njeriut.

Feja është një ligj i vendosur prej anës së All-llahut xh.sh. që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes njerëzore dhe përsosjen e njeriut në çdo aspekt duke ia mësuar virtytin e shkallës më të lartë të moralit, duke ia përcaktuar mënyrën e sjelljes që duhet pasur ai ndaj krijesit, ndaj vetes, shoqërisë dhe rrethit ku jeton.

Se feja vërtet është faktor kryesor në stabilizimin shpirtëror të njeriut, tregon edhe vetë koha në të cilën jetojmë, e cila fatin e njeriut e sheh dhe e përqendron vetëm nëpërmjet të mirave materiale, shkencës e teknologjisë, përkundrazi njeriu gjithnjë e më tepër po përjeton një pasiguri dhe një krizë të madhe morale e shpirtërore, në të cilën krizë dhe pasiguri, mbështetje dhe strehim mundohet të gjejë në krime, vrasje e në shumë raste edhe në vetëvrasje, si rezultat i kësaj është që njeriu është larg fesë.⁶⁸

Islami është një fe që i është shpallur njerëzimit me qëllimin e dhurimit të një jete paqësore, nëpërmjet së cilës pasqyrohet në tokë mëshira dhe bamirësia e pafund e Zotit.

Islami i cili përbën hallkën e fundit të fesë hyjnore, na mëson se njeriu, i cili është qenia më me vlerë e gjithësisë, duhet të dëgjojë dhe ta pranojë zërin e qiellit, i cili do ta

⁶⁸. Shaqir Fetahu, “Feja, fenomen i vërtetë”, Shkup 1997, f. 69.

shpëtojë atë nga humbja dhe do t'ia shkurtojë rrugën drejt paqes së sigurt dhe të garantuar, në kuadër të familjes mbarënjërzore.⁶⁹

Burimi hyjnor i islamit është Kur'ani dhe tradita e Muhamedit a.s. që mbështet në konceptet e moralit.

Vepra penale mbyjtja (vrasja), në bazë të parimeve dhe principeve islame konsiderohet edhe veprim kundër moral. Andaj, veprim i ndaluar sipas ligjit islam konsiderohet çdo veprim i cili nuk përputhet me rregullat dhe me parimet esenciale të moralit. Dijetari islam bashkëkohor dr. Jusuf El Kardavi në lidhje me këtë princip thotë: *“Në brendësinë e qenies së njeriut ekziston një fuqi e cila nuk mund të shihet me anë të syrit e as me anë të mikroskopëve dhe që nuk e njeh as shkenca e anatomisë. Ajo është një fuqi kuptimore e cila vetëm përjetohet, e cila njeriun e shpien nga e mira dhe e largon nga e keqja. Kjo fuqi është që dijetarët e etikës e quajten “ndjenjë” e për të cilën Muhamedi a.s. kur është pyetur për mirësinë ka thënë: “Mirësia është ajo e cila te e cila pushon shpirti dhe zemra (ndjenja), kurse mëkati (krimi) është ajo në të cilën nuk pushon shpirti dhe zemra (ndjenja).”*⁷⁰

Ndjenja është një fuqi e cila i paraprinë veprës. Atëherë kur ekzistojnë zemra të gjalla të mbushura me ndjenja të shëndosha pa mëdyshje se edhe ligji është i drejtë dhe i frytshëm. Mbi këtë parim ngrihet edhe urtësia e thënies se: *“Drejtësia nuk qëndron në tekstin e ligjit, por në ndjenjën e gjykatësit.”*⁷¹

⁶⁹. Ajni Sinani, “Islami besim, ligj, kulturë dhe qytetërim”, Prishtinë 2007, f. 17.

⁷⁰. Dr. Jusuf El Kardavi, “El Iman vel Hajat”, Kajro f. 208

⁷¹. Dr. Jusuf El Kardavi, vep, cit, f. 208.

Feja islame në princip e bën lidhshmërinë e plotë mes realitetit të fuqisë absolute, ndjenjës individuale dhe moralit të shoqërisë. Andaj, ndjenja dhe morali në parimin islam nuk ngrihen mbi bazat e asaj që e njohin njerëzit si të mirë apo të keqe, por ato ngrihen mbi bazat fundamentale që i ka përkufizuar Kur`ani dhe suneti mbi të cilat ngrihet shoqëria e pastër njerëzore e që në brendësi e ka mëshirën dhe drejtësinë.

Sipas parimeve islame, nëse njeriu arrin që në zemrën dhe shpirtin e tij ta përforcojë ndjenjën fetare, pa mëdyshje se ajo do të ndikojë shumë pozitivisht në pengimin dhe largimin e subjektit nga vepra penale. I tërë ky ndikim mund të përfshihet në këto tre segmente që janë:

1. Feja islame është fe dhe sistem nga All-llahu xh.sh. dhe se çdo send që ekziston në univers është krijesë e All-llahut xh.sh. Nëse njeriu e beson fuqinë absolute dhe me veprimtarinë e tij e krijon lidhjen e fortë me Krijuesin e tij, ajo ndikon që nga shpirti dhe zemra e tij të largohet egoizmi, bigotizmi me të gjitha elementet dhe qelizat shtytëse nga krimi siç janë zilia, urrejtja, mëria, vardisja ndaj pasurisë etj. Dhe në të njëjtën kohë këtë zbrazëtim të kompensojnë me mëshirë, dashuri, humanizëm, solidaritet etj. Si shembull mund ta cekim obligimin e faljes së namazit, për të cilën All-llahu xh.sh në Kur`an thotë:

وَأَقِمِ الصَّلَاةَ ۖ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ
وَالْمُنكَرِ ۚ

“...fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irtuarat...”⁷²

⁷². El Ankebut, 45.

Në këtë kontekst mund të përkujtojmë dhe të bëjmë analizë mbi ndikimin e shumë obligimeve tjera siç është agjërimi, dhënia e zeqatit etj.

2. Feja islame është djep i moralit të lartë, me të cilën ka krijuar një shoqëri me virtyte dhe me edukim të lartë dhe në anën tjetër sanksionon masa ndëshkuese për ata që orvaten për prishjen e rendit dhe moralit. Sheriati islam llogarit se me prishjen e moralit prishet edhe shoqëria, krijohen çrregullime dhe devijime që pa mëdyshje shpijnë në krime - vrasje vepra penale.

3. Besimi në All-llahun xh.sh. dhe në cilësitë e Tij paralajmëron dënime jo vetëm në jetën e kësaj bote, por edhe në botën tjetër. Besimtari islam i cili vepron ndonjë veprim të ndaluar duke pasur parasysh dënimin e vështirë të jetës së botës tjetër, shpeshherë pendohet në jetën e kësaj bote që të pastrohet nga mëkati.

Ai është i vetëdijshëm dhe i bindur se nëse për çdo veprim që e vepron, pavarësisht se është i mirë apo i keq, do të regjistrohet te All-llahu xh.sh. dhe si i tillë nëse arrin të shpëtojë nga dënimi i jetës skësaj bote, nuk do të ketë mundësi të shpëtojë nga dënimi i jetës së botës tjetër dhe si i tillë kur është i bindur në këtë, ai largohet nga krimet - vrasjet.⁷³

Përgjegjësia për veprim penal

Në bazë të parimeve fetare islame, personi i cili kryen krim vepër penale, bart dy përgjegjësi:

1. Përgjegjësinë për vepër penale në jetën e kësaj bote për të cilën meriton sanksion. Kjo përgjegjësi para së gjithash ka për qëllim pastrimin e vetë pastruesit të krimit në njërën anë e në anën tjetër ruajtjen e sigurimit, të paqes dhe të rendit shoqëror në përgjithësi.

⁷³. Jusuf Zimeri, "E drejta penale islame", Shkup 1998, f. 9.

2. Përgjegjësinë e veprës në jetën e botës tjetër për personin i cili nuk pastrohet nga krimi në jetën e kësaj bote.⁷⁴ All-llahu xh.sh në lidhje me këtë, thotë:

يَوْمَ تَجِدُ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ مِنْ خَيْرٍ مُحْضَرًا وَمَا
عَمِلَتْ مِنْ سُوءٍ تَوَدُّ لَوْ أَنَّ بَيْنَهَا وَيَنبَهُ أَمَدًا بَعِيدًا ۚ
وَيُحْذِرُكُمُ اللَّهُ نَفْسَهُ ۚ وَاللَّهُ رَءُوفٌ بِالْعِبَادِ ﴿٧٥﴾

“Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vetes atë që veproi mirë ose keq, e për atë të keqe që e bëri, do të dëshirojë që në mes tij dhe në mes të asaj të jetë një distancë shumë e madhe (e mos ta shohë). All-llahu u jep të frikësohen prej dënimit që vjen prej Tij, megjithëqë All-llahu është i mëshirshëm ndaj robërve.”⁷⁵

Islami në misionin e tij erdhi për ta ngritur ndjenjën e përbashkët në mesin e besimtarëve, ndërsa metoda që e përdori për këtë, është se ai krijoi midis çdo individi shenjtëri të cilat duhet të ruhen. Për këtë qëllim, ai caktoi të drejtën e cila nuk bën të cenohet dhe detyrimin që duhet të kryhet ndaj të tjerëve.

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

﴿قُلْ تَعَالَوْا أَتْلُ مَا حَرَّمَ رَبِّيَ عَلَيْكُمْ ۖ أَلَّا تُشْرِكُوا
بِهِ شَيْئًا ۖ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ۖ وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِّنْ

⁷⁴. Jusuf Zimeri, vep. cit. f. 9.

⁷⁵. Ali Imran, 30.

إِمْلَقِ نَحْنُ نَرْزُقُكُمْ وَإِيَّاهُمْ وَلَا تَقْرُبُوا الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَنَ وَلَا تَقْتُلُوا النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ ذَلِكُمْ وَصَّيْكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

“Thuaj: "Ejani t'ju lexoj atë që me të vërtetë ju ndaloj Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të haptë apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloj All-llahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë.”⁷⁶

Misioni islam ndaj shoqërisë është mision njerëzor, mision i paqes, i ruajtjes së integritetit, mision i sigurisë dhe i qetësisë, mision i edukimit.

Vlera njerëzore dhe interesi i përgjithshëm janë dy komponentë të pandashëm mes veti. Këto synime, këto intencë të mësimit islam janë të orientuara drejt mbrojtjes së pesë vlerave themelore të përhershme që e përbëjnë thelbin themelor të fesë dhe të drejtës islame. Sipas dijetarëve islam, me sheriatin islam në mënyrë imperative kërkohet:

1. **Mbrojtja e fesë,**
2. **Mbrojtja e jetës dhe e trupit,**
3. **Mbrojtja e pasurisë private dhe shoqërore,**
4. **Mbrojtja e pasardhësve, e nderit dhe moralit publik,**

⁷⁶. El En'Am, 151.

5. Mbrojtja e arsyes dhe syçelësisë.⁷⁷

Filozofia e fesë islame në ruajtjen e këtyre interesave ngrihet mbi garancinë e jetës dhe mbi ngritjen e njeriut – të personalitetit, andaj mosrespektimi i njërës prej këtyre vlerave paraqet vepër penale për të cilën parashihen sanksione që quhen *hudud*. Sa herë që cenohen këto vlera dhe interesa, sheriatu islam parashih sanksione rigoroze, kurse me shqiptimin dhe me ekzekutimin e këtyre sanksioneve në shoqërinë njerëzore realizohen këto vlera: *ndërprerja e krimeve, realizimi i drejtësisë, përmirësimi dhe rehabilitimi i kriminelit*.

Mbrojtja e jetës

Sa i përket pikës së dytë, e drejta për jetesë është e drejtë hyjnore e njeriut, me përjashtim të disa rasteve. Allahu xh.sh. thotë:

مَنْ قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا

قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا

“... kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është sikur t'i kishte mbytur të gjithë njerëzit...”,⁷⁸ mirëpo mos prezenca e islamit në botën njerëzore, me ose pa arsye, mbytjen e njeriut e shndërron sikur pirjen e ujit. Në kohën tonë të cilën e konsiderojmë si kohë të civilizimit, i gjejmë këto fakte:

⁷⁷. Nexhat Ibrahim, “Shkolla juridike hanefite dhe karakteristikat themelore të doktrinës së saj”, Prizren 2000, f. 56.

⁷⁸. El Maide, 32.

- Për shkak të realizimit të idesë komuniste, në Rusi u mbytnë 19.000.000 njerëz, u gjykuan me dënime të ndryshme flagrante, u internuan 4 - 5.000.000 njerëz. E në fund çdo të thonë këta numra? - A mos kuptohet se ndoshta atje ka vlerë jeta njerëzore?!

-Ç`do të thonë bombat atomike dhe të hidrogjenit?

-Ç`do të thonë masakrat kolektive në shtetet kolonialiste?

-Ç`do të thonë kasaphanat në shtetet jo të qeta ku populli lufton për të drejtat elementare?

-Ç`do të thotë ndërtimi i kalave me kafka njerëzore?

-Ç`do të thonë luftërat botërore etj.? ⁷⁹

Prej gjithë kësaj kuptojmë se jeta njerëzore nuk ka aspak vlerë. Mirëpo, kur Islami është prezent, njerëzit nuk mbyten përveç se me të drejtë.

Njerëzit e pafajshëm vriten barbarisht dhe vendet ku nxitet urrejtja mes grupeve të ndryshme shoqërore për arsye tërësisht artificiale, zhyten në gjakderdhje.

Këto tmerre në vendet me histori, me kultura dhe struktura të ndryshme shoqërore, mund të kenë shkaqe dhe burime nga më të çuditshmet. Sidoqoftë, është e dukshme se shkaku themelor është largimi nga morali i mbështetur në dashuri, respekt e tolerancë, për të cilën ka urdhëruar Zoti në Kur'an. Si pasojë e mungesës së fesë, lindin grupe shoqërore që nuk e njohin frikën ndaj Zotit dhe që besojnë se nuk do të japin ndonjëherë llogari për veprat e tyre. Përderisa besojnë se nuk kanë kujt t'i japin llogari për asgjë, ata e kanë të lehtë për të vepruar pa mëshirë, pa moral dhe ndërgjegje.⁸⁰

Është jashtë çdo mundësie që dikush që i beson me të vërtetë Zotit të mund të bëjë një sy verbër qoftë dhe përballë

⁷⁹ . www.bim.org.mk/arhivi/1974_ndikimi.htm - 81k

⁸⁰ . Harun Jahja "Islami dënon terrorizmin" f. 20.

një veprimi që mund t'i shkaktojë dëmin më të vogël njerëzimit, kurse dikush që nuk beson në Zotin dhe në jetën e pasur, mund të kryej lehtësisht çdo lloj të keqeje, përderisa mendon se nuk do t'i duhet t'i japë llogari askujt për veprat e veta.

Feja i kushton rëndësi të madhe edukimit të ndërgjegjes njerëzore dhe atë e konsideron bazë kryesore për pengimin e krimit, duke marrë parasysh se ndërgjegjja fetare ka ndikim të madh në sjelljet e njeriut të ndërgjegjshëm. Ai e di se është nën mbikëqyrje të vazhdueshme. Për çdo veprim që bën ai, i vogël qoftë apo i madh, ai e kupton se nëse ai mund të fshihet nga sytë e njerëzve, nuk mund të fshihet nga All-llahu xh.sh.

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ﴿٧﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ

مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ﴿٨﴾

“E kush punoi ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”⁸¹

Nëse ndërgjegjja fetare është në nivelin e duhur te individi, atëherë ai është i sigurt se nuk mund të bëjë krime. Ai tërë jetën e tij e kalon me moral të lartë, i qetë, nuk ka zili ndaj njerëzve dhe as nuk i përgojon ata.

⁸¹. Ez Zelzele, 7-8.

ISLAMI E NDËSHKON MBYTËSIN (vrasësin)

Islami në rend të parë e çmon jetën e njeriut në një kuptim të përgjithshëm e absolut të fjalës, duke e respektuar të drejtën e secilit njeri për jetë dhe për mbrojtjen e tij. Ai edhe e ka përcaktuar dënimin me vdekje pikërisht për shkak të mbrojtjes së vetë jetës, duke mos e shikuar postin dhe përkatësinë shoqërore, ekonomike, politike, racore, nacionale apo fetare të vrasësit.

All-llahu xh.sh. në librin e tij famëlartë kërcënon se atë që mbyt padrejtësisht një njeri, e pret një dënim i rëndë i cili ndëshkohet nga ana e All-llahut dhe të gjitha veprat e tij në këtë jetë zhduken, kurse në botën tjetër për të nuk ka ndihmëtarë.

Lidhur me këtë, All-llahu xh.sh thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَيَقْتُلُونَ النَّبِيَّ
بِغَيْرِ حَقٍّ وَيَقْتُلُونَ الَّذِينَ يَأْمُرُونَ بِالْقِسْطِ مِنَ
النَّاسِ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٥١﴾

“Ata që mohojnë argumentet e All-llahut, mbysin pejgamberët pa kurrfarë të drejte, mbysin edhe njerëzit që këshillojnë për të drejtën, ti ata lajmëroi për një ndëshkim të dhembshëm e pikëllues.”⁸²

“Ata që mohojnë argumentet e All-llahut, është fjala për Kur'anin dhe për mrekullitë e tjera të Pejgamberit a.s.

⁸². Ali Imran, 21.

“*Mohuesit*” është në përgjithësi, për të gjithë mohuesit (qafirët), “*mbysin pejgamberët pa kurrfarë të drejte*”, ata janë hebrenjtë të cilët në një kohë dreke kanë vrarë dyzet e tre pejgamberë dhe pastaj deri në kohën e pas drekës (iqindisë), kanë vrarë njëqind e dymbëdhjetë veta, prej atyre që u munduan t’i ndalonin të mos i vrisnin pejgamberët. Këtë e ka treguar Ebu Ubejde nga një fjalë e Pejgamberit a.s.⁸³

Ky ajet bën të kuptosh se edhe vrasja e atyre njerëzve që urdhërojnë të tjerët për punë të mira, është sikur t’i vrasësh pejgamberët.

Zoti pasi urdhëroi Pejgamberin a.s. që të paralajmërojë me ndëshkim vrasësit e pejgamberëve dhe të atyre që urdhërojnë me drejtësi, për të treguar edhe se vrasësve do t’u zhvlerësohen punët e tyre të mira dhe se për ata nuk do të ketë ndihmues, urdhëron e thotë:

أُولَئِكَ الَّذِينَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ

وَمَا لَهُمْ مِّنْ نَّاصِرِينَ ﴿٢٢﴾

“Ata veprat e tyre i asgjësuan në këtë botë dhe në botën tjetër, ata nuk kanë ndonjë mbrojtës”.⁸⁴

S’do mend se vepra penale e mbytjes është delikt i cili meriton ndëshkim në të dy botët, në lidhje me këtë All-llahu xh.sh. thotë:

⁸³. H. Hafiz Ibrahim Dalliu, “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Kerimit”, Tiranë 2005, f. 306.

⁸⁴. Ali Imran, 22.

وَمَنْ يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُتَعَمِّدًا فَجَزَاؤُهُ جَهَنَّمُ خَالِدًا فِيهَا

وَوَغَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُ وَأَعَدَّ لَهُ عَذَابًا عَظِيمًا ﴿١٦﴾

“Kush e mbyt një besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehenemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. All-llahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh.”⁸⁵

Fjala “dënimi i tij është xhehenemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë”, është për qëndrimin e tij në xhehenem për një kohë tepër të gjatë, aq sa duket si kohë e përjetshme. Ajeti mund të jetë i veçantë për atë që e konsideron vrasjen veprim të lejuar (hallall); në këtë rast fjala “*haliden*” (përgjithmonë), është në kuptimin e saj të kryehershëm, d.m.th. vrasësi do të qëndrojë në xhehenem për jetë, për shkak se ai nuk e ka pranuar vrasjen si veprim të ndaluar (haram) dhe kështu ai ka dalë nga feja islame. Sido që të jetë qëllimi, ajeti tregon haptë se për vrasësin me paramendim ka një ndeshkim shumë të rreptë dhe se kjo vrasje përveç mosbesimit (shirkut), është një faj më i rëndë se të gjitha fajet tjera.⁸⁶

Andaj edhe aksenti më i madh i vështirësive të përgjegjësisë së tij para Zotit, i është vënë këtij krimi. Pejgamberi a.s. në një hadith thotë: “*Gjykimi, krimi i parë, i cili do të prezantohet para Zotit për gjykim në ditën e Ahiretit është*

⁸⁵. En Nisa, 93.

⁸⁶. H. Hafiz Ibrahim Dalliu, vep. cit. f. 503. Disa kanë thënë se ,atij që vret me paramendim, nuk i pranohet as pendimi (teubja). Por, kjo thënie nuk është e arsyeshme, sepse siç thotë Fahri Rraziu – meqenëse pendimi (teubja), i pranohet idhujtarit, atij që i përshkruan shok Zotit, që është faj i më i keq se të gjithë fajet tjera, edhe vrasësit patjetër duhet t’i pranohet pendimi (teubja).

gjaku, dorasi i gjakderdhjes.”⁸⁷ Pejgamberi a.s. në lidhje me atë që e thamë deri më tani thotë: “*Nëse dy besimtarë (grinden) dhe njëri prej tyre përdor armën kundër tjetrit, atëherë që të dy janë në prag të xhehenemit, e nëse njëri prej tyre vret tjetrin, atëherë që të dy do të hyjnë në xhehenem*”. Kur i është shtruar pyetja se: “Kjo ka të bëjë me vrasësin, por ç’bëhet me të vrarin?”, ai është përgjigjur: “*Edhe ai deshironte vrasjen e shokut të vet.*”⁸⁸

Për shkak të kësaj, Pejgamberi a.s. ka ndaluar çdo akt që shkakton vrasje ose luftë, bile edhe drejtimin e armës. Në këtë kontekst, ai ka thënë:

لَا يُشِيرُ أَحَدُكُمْ عَلَى أَخِيهِ بِالسَّلَاحِ فَإِنَّهُ لَا يَدْرِي لَعَلَّ الشَّيْطَانَ
يَنْزِعُ فِي يَدِهِ فَيَقَعُ فِي حُفْرَةٍ مِنَ النَّارِ

***“Askush prej jush s’duhet ta drejtojë armën drejt vëllait të vet, ngase djalli (iblisi - shejtani) mund ta shtyjë dorën e të zhytet në greminën e xhehenemit (zjarrit).*”⁸⁹**

Në bazë të këtyre citateve kur’anore dhe haditheve të Pejgamberit a.s. kuptojmë se njeriu i cili kryen një vepër penale siç është vrasja e njeriut, atë e pret një ndëshkim i ashpër nga ana e All-llahut fuqiplotë në botën tjetër në xhehenem dhe në këtë botë do të jetë prej të nënçmuarve.

⁸⁷. Sherif Ahmeti, “Komente dhe mendime islame”, Prishtinë 1995, f. 273.

⁸⁸. Dr. Jusuf El - Kardavi “Hallalli dhe harami në Islam”, Prishtinë 2002, f. 402.

⁸⁹. Transmeton Buhariu.

KAPITULLI I TRETË

MBYTJA (vrasja) SIPAS TË DREJTËS SË SHERIATIT

» MBYTJA (vrasja) VEPËR PENALE

» LLOJET E MBYTJES (vrasjes)

» SANKSIONET (MASAT NDËSHKIMORE) E VEPRËS
PENALE SIPAS SHERIATIT

» SANKSIONET (MASAT NDËSHKIMORE) NË LIGJET
TJERA

» PAJTIMET

MBYTJA (vrasja) VEPËR PENALE

Para së gjithash duhet t'i kushtojmë një rëndësi të veçantë përkufizimit të veprës penale sipas sheriatit islam dhe filozofisë së saj.

Juristët myslimanë, njësoj sikurse edhe ekspertët bashkëkohorë të së drejtës penale, kanë mendime të ndryshme sa i përket përkufizimit të veprave penale, duke e konsideruar vrasjen si vepër penale dhe cenim i jetës së njeriut dhe duke paraparë masa ndëshkuese sipas sheriatit për krimin e bërë.

“Me vepër penale nënkuptojmë atë që është e ndaluar sipas legjislacionit islam, kuptohen aktivitetet që cenojnë dhe atakojnë jetën e njeriut, pasurinë e tij ose diçka tjetër.”⁹⁰

“Sipas kodit penal të Egjiptit: *“Vepër penale konsiderohet ai veprim që sipas ligjit penal është paraparë dënimi kapital - likuidimi apo dënim me punë të rëndë apo me heqje lirie.”⁹¹*

Juristi i njohur islam El-Maverdiu, veprën penale duke përfshirë çdo vepër penale si vepër kriminale, e definon si: *“Vepra penale në të drejtën islame janë vepra të ndaluara juridikisht, të cilat Zoti i ka vendosur dhe të cilat ndëshkohen me dënimin e “hadit” ose “ta’zirit”. Pra, ekzistojnë dy lloj vepra penale: vepra penale për të cilat ndëshkimi është përcaktuar me dispozitat e Kur’anit dhe Sunnetit (hadd⁹²) dhe*

⁹⁰. Dr. Vehbi Zuhejli, “Fikhu el-islami”, Damask 1988, 6, f. 17.

⁹¹. Dr. Abdulkadër Aude, “Teshriu el-xhinai el-islami mukaren bil kanun el-vedi”, Kajro 1966, f. 5.

⁹². Fjala “*hadd*”, shumësi “*hudud*”, në aspektin gjuhësor do të thotë kufi, pengesë, ndalim, ndërkaq sipas terminologjisë juridike, nënkupton ato ndëshkime që janë përcaktuar tekstualisht me Kur’an ose me Sunnet. Ndëshkimi i mëkatarit është emëruar me fjalën hadd, sepse në të shumtën

vepra të cilat ndëshkohen sipas vlerësimit të njerëzve të pushtetit (ta'zir⁹³). ”⁹⁴

Profesori i të drejtës penale islame Dr. Kemal Xhevdeh, veprën penale e definon si: *“Mëkat dhe krim që e ka kryer njeriu gjatë veprimit të lirë, për të cilin veprim meriton dënim në këtë botë dhe në botën tjetër.”⁹⁵*

Dijetari me famë i të drejtës së sheriatit, Ibn Ruzhdi thotë se vepra penale e përcaktuar sipas sheriatit islam është: *“Vepra penale e shkaktuar ndaj njeriut, jetës dhe gjymtyrëve të trupit të tij, e njohur si vrasje, plagosje dhe gjymtime.”⁹⁶*

Juristi i të drejtës penale dhe ligjërues në Universitetin e Damaskut dr. Abbud Serraxhi, thotë se veprat penale që meritojnë sanksione apo masa sanksionuese ndahen në:

1. *Vepra penale për të cilat janë paraparë sanksione të përcaktuara që njihen si: “El-had”, ku me ekzekutimin e këtyre sanksioneve, zbatojmë një të drejtë ngase paraprakisht kemi thyer të drejtën hyjnore.*

2. *Vepra penale që meritojnë masën sanksionuese të njohur në sheriatin islam si “el-kisas”-gjakmarrje dhe “ed-dije”-kompozicion.*

e rasteve ai e ndalon dhe e pengon kryerësin e veprës që të kthehet edhe një herë në një delikt të tillë.

Sa i përket kategorisë së hadd-it, kadisë nuk i është e lejuar që të tërhiqet nga dënimi i përcaktuar.

⁹³. *“Tazir” është dënim për shkelje të caktuara, masa e ndëshkimit të cilave i është lënë kadiut. Ky dënim mund të ketë formë dhe nivel të ndryshëm, por nuk mund t’ia kalojë dënimeve ligjore të përcaktuara me tekst “hadd”.*

⁹⁴. EL-MAVERDI , “Ahkam es-sulltanije”, Kajro 1983, f. 189.

⁹⁵. Kemal Xhevdet ebu El-`ata Mustafa, “Ukubu el-xhinaije ala en-nefs”, Kajro 1986, f. 29.

⁹⁶. Ibni Ruxhdi, “Bidajetul muxhtehid”, Kajro 1379 h., botimi i 3.

Ky lloj sanksioni parashihet te vrasja me të cilin akt preket e drejta e individit, i cili me këtë rast ka të drejtë të zgjedh se për cilin lloj të sanksionit do të përcaktohet, ngase ndjekja bëhet sipas akuzës private,⁹⁷ ngase me atë rast është dëmtuar e drejta e individit drejtpërdrejtë përmes veprës kriminale e kriminelit. Pra, ai ka përparësi që të kërkojë vetë ose familja e tij që t'i shërohet plaga e shkaktuar. Me këtë rast, individit ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar material dhe psikik. Ky rregull ngrihet nga ajeti kur'anor ku All-llahu xh.sh. thotë:

وَكُتِبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنْ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ
بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ وَالْأُذُنَ بِالْأُذُنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ
وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ فَمَنْ تَصَدَّقَ بِهِ فَهُوَ كَفَّارَةٌ لَهُ
وَمَنْ لَمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmasat ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e falë atë (hakmarrjen), ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti All-llahu, ata janë mizorë (të padrejtë).”⁹⁸

⁹⁷. Dr. Kemal Xhevdet Mustafa, vep. cit. f. 26.

⁹⁸. El Maide, 45.

LLOJET E MBYTJES (vrasjes)

Sipas fukahave të shkollës juridike hanefite, mbytja mund të jetë pesë lloje: mbytje me qëllim, mbytje si me qëllim, mbytje me gabim, mbytje si me gabim dhe mbytje me shkak. Kurse sipas mendimit të malikijve, mbytja është dy lloje: me qëllim dhe me gabim

Kurse sipas mendimit të fukahave të shkollës juridike shafite dhe hanbelite, mbytja mund të jetë tre llojesh:

1. MBYTJA ME QËLLIM
2. MBYTJA SI ME QËLLIM
3. MBYTJA ME GABIM

MBYTJA ME QËLLIM

Mbytja me qëllim sipas parimeve të sheriatit islam, konsiderohet atëherë kur kryerësi i veprës për realizimin e veprës penale të mbytjes, përdor mjet mbytës (armë të zjarhtë ose të ftohtë) siç është revolja, thika, shpata, me kusht që pas goditjes, personi i goditur të vdesë.”⁹⁹

Shtyllat (ruknet) e mbytjes me qëllim

1. *Që i mbyturi të jetë njeri i gjallë dhe gjaku i tij është i siguruar sipas islamit.*

Nga kjo nënkuptohet se vepra penale “mbytja me qëllim” që sanksioni i saj është kisasi - gjakmarrja, është

⁹⁹. Prof. Jusuf Zimeri, “Dispencë për vitin e IV shkolla e mesme islame, MIS. Shkup” 1998. f. 14

veprim armiqësor mbi njeriun, që gjaku i tij juridikisht është i mbrojtur sipas parimeve islame.

2. *Që mbytja të shkaktohet nga dora e dikujt drejtpërdrejtë.*

Vepra penale mbytje me qëllim nuk mund të trajtohet si e tillë vetëm atëherë kur kryerësi i veprës kryen veprim i cili rezulton me vdekje, respektivisht përfundon me vdekje. Në këtë rast, që vepra të trajtohet penale apo mbytje me qëllim, nuk kushtëzohet që veprimi të jetë i një lloji të veçantë, por ai mund të jetë nga llojet e ndryshme si p.sh. të goditurit me diçka, shkaktimi i plagës, therja, prerje, djegia, zënia e frymës, helmimi, etj.¹⁰⁰

Mjeti mbytës

Meqë mjetet me të cilat shkaktohet mbytja nuk janë të gjitha të një rangu sa i përket fuqisë shkaktese në trupin e njeriut, dijetarët e medhhebit hanefij, që vepra penale të konsiderohet mbytje me qëllim, kanë kushtëzuar që mjeti i përdorur për mbytje të jetë nga ato mjete që në të shumtën e rasteve shkaktajnë mbytje e ato janë mjete të cilat shkaktajnë plagë, mjete shpuese që kanë teh të mprehtë, mjete që copëtojnë trupin e njeriut pavarësisht se ato mjete janë nga hekuri, alumini, druri apo guri. Gjithashtu, në të përfshihet edhe mjeti i cili shkakton vdekje dhe plagë siç është zjarri, qelqi etj.

3. *Që mbytësi të ketë për qëllim mbytjen.*

Nëse kryerësi i veprës nuk ka për qëllim mbytjen e tij por vetëm rrahjen apo frikësimin e tij, atëherë vepra nuk trajtohet mbytje me qëllim. Mirëpo meqë qëllimi është çështje e fshehtë, atëherë dijetarët islam për të zbuluar qëllimin e tij, bënë analiza në mjetin e përdorur për mbytje ashtu si i përmendëm më parë.

¹⁰⁰. Abdul kadër Aude, “Eteshriul xhenai” Kajro 1969, 2/25-26.

Llojet e mbytjes me qëllim

1. Mbytja me mjetin mprehës

Mjet i mprehtë konsiderohet çdo mjet i cili pret, shpon apo copëton trupin e njeriut si p.sh., arma e zjarhtë, arma e mprehtë nga hekuri, druri, guri, qelqi, ashti etj. Të gjithë dijetarët islam janë unik se mbytja me këtë lloj mjeti konsiderohet vepër penale- mbytje me qëllim.

2. Mbytja me mjet të rëndë

Mjet i rëndë konsiderohet çdo mjet i cili nuk ka teh të mprehtë siç është shkopi, guri etj. Në këtë lloj mbytjeje, dijetarët islam kanë kundërthënie se a trajtohet mbytje me qëllim dhe se duhet ekzekutuar sanksionin e mbytjes me qëllim apo është mbytje si me qëllim dhe duhet te paguhet gjaku “dije.”

Sipas mendimit të Ebu Hanifes, mbytja me këto mjete, me përjashtim nëse mjeti është nga hekuri apo alumini, mbytja trajtohet si me qëllim. Argumenti në të cilin mbështetet Ebu Hanifja është hadithi i Pejgamberit a.s. ku ka thënë:

ألا وإن كل قتيل خطأ العمد أو شبه العمد قتيل السوط والعصاو
الحجر ماء من الإبل

“Vërtetë çdo mbytje me qëllim konsiderohet mbytja me kamxhik, shkop dhe gurë, e për të paguan njëqind deve.”¹⁰¹

Sipas mendimit të Ebu Jusufit dhe Muhamedit, nëse mjeti në të shumtën e rasteve shkakton vdekjen e personit, pavarësisht se mjeti a është i madh apo i vogël, konsiderohet mbytje me qëllim sepse pasi që mjeti në të shumtën e rasteve shkakton

¹⁰¹. Transmeton Ahmedi dhe as-habu sunen me përjashtim të Tirmidhiut, marrur nga ibn Omeri.

vdekje, atëherë trajtohen nga mjetet mbytëse me qëllim, ndërsa në të kundërtën vepra trajtohet mbytje si me qëllim.

Kurse sipas mendimit të imam Shafiut dhe imam Hanbelit, mbytja me mjet të rëndë trajtohet si mbytje me qëllim, argument i tyre është rasti kur Pejgamberi a.s. ia kishte shqiptuar kisasin- gjakmarrjen një çifuti i cili kishte mbytur një grua me gurë.¹⁰²

3. Mbytja direkt

Mbytja direkt konsiderohet kur kryerësi i veprës me veprimin e tij ka për qëllim mbytjen e tjetrit në mënyrë direkt, pavarësisht se veprimi kryhet me mjet dëmtues apo me varje. Në këtë lloj mbytjeje të gjithë fukahatë janë unik se ndaj kryerësit të veprës ekzekutohet sanksioni i kisasit - gjakmarrjes. Në këtë kontekst vetëm të përmendim në mënyrë kalimthi se mbytja në mënyrë direkt, ose mund të kryhet nga një person ose nga shumë persona.

Nëse në mbytjen e një personi marrin pjesë shumë njerëz edhe atë në mënyrë direkt, të gjithë dijetarët islam janë unik në mendimet e tyre se ndaj të gjithëve ekzekutohet sanksioni i kisasit. Gjykohet kështu që të ruhet interesi i përgjithshëm njerëzor, sepse zakonisht mbytjet shkaktohen nga ky lloj.

4. Mbytja me imponim

Mbytje me imponim konsiderohet kur një individ ia imponon tjetrit mbytjen e një individi tjetër (të tretë), duke iu kërcënuar me mbytje. Në këtë rast sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe Muhamedit, ekzekutimi i sanksionit të kisasit - gjakmarrjes bëhet mbi imponuesin e jo mbi të imponuarin. Ky mendim mbështetet në hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë:

¹⁰². Dr. Vehbe Ez-Zuhejli, “El Fikhul Islamij ve ediletuhu”, Kajro 1992, 6/234.

إن الله تجاوز عن أمتي الخطأ والنسيان وما استكرهوا
عليه

“Vërtetë Allahu xh.sh. nga Umeti im ka ngritur mëkatin e gabimit, harresës dhe asaj që u është imponuar atyre.”¹⁰³

Sipas mendimit të Ebu Hanifes, i imponuar trajtohet vetëm mjeti në dorën e imponuesit, andaj edhe sanksioni i kisasit - gjakmarrjes ekzekutohet mbi imponuesin.

Sipas mendimit të Ebu Jusufit, sanksioni i kisasit – gjakmarrjes nuk ekzekutohet mbi asnjërin, kurse sipas mendimit të Imam Zuferit, sanksioni ekzekutohet mbi të imponuarin, sepse ai është ekzekutues direkt i veprës. Vlen të përmendet se mendimi më i pranuar në medhheb është mendimi i parë.

MBYTJA SI ME QËLLIM

Mbytja si me qëllim konsiderohet ajo mbytje kur për të mbytur ekziston armiqësia, por e përdor mjetin i cili në të shumtën e rasteve nuk trajtohet si mjet mbytës e as që e zëvendëson mjetin mbytës, që do të thotë se mjeti mbytës nuk është mjet copëtues i gjymtyrëve të njeriut si p.sh. përdorimi i shkopit, gurit apo i drurit.¹⁰⁴

Te dijetarët e medhhebit hanefij, për mbytjen e personit me mjet të rëndë, gjejmë mendime kontradiktore dhe atë varësisht nga këndvështrimi se cili mjet konsiderohet i rëndë. Sipas mendimit të Ebu Hanifes, mbytje me këto mjete me përjashtim nëse mjeti është nga hekuri apo alumini, mbytja trajtohet si me qëllim. Argumenti ku mbështetet Ebu Hanifja është hadithi i Pejgamberit a.s. ku ka thënë:

¹⁰³. Transmeton Ibni Maxhe.

¹⁰⁴. Prof. Jusuf Zimeri, vep cit. f. 26.

ألا وإن كل قتل خطأ العمد أو شبه العمد قتيل السوط والعصا
الحجر مأمة من الإبل

“Vërtetë çdo mbytje si me qëllim konsiderohet mbytja me kamxhik, me shkop dhe gurë, e për të paguan njëqind deve.”¹⁰⁵

Sipas mendimit të Ebu Jusufit dhe Muhamedit, nëse mjeti në të shumtën e rasteve shkakton vdekjen e personit, pavarësisht se mjeti a është i madh apo i vogël, konsiderohet mbytje me qëllim, sepse pasi që mjeti në të shumtën e rasteve shkakton vdekje, atëherë trajtohen nga mjetet mbytëse me qëllim, në të kundërtën vepra trajtohet mbytje si me qëllim. Kurse sipas mendimit të imam Shafiut dhe imam Hanbelit, mbytja me mjet të rëndë trajtohet si mbytje me qëllim, argument i tyre është rasti kur Pejgamberi a.s. ia kishte shqiptuar kisasin - gjakmarrjen një çifuti i cili e kishte mbytur një grua me gurë.¹⁰⁶

MBYTJA ME GABIM

Mbytja me gabim është mbytja kur kryerësi nuk ka për qëllim mbytjen e as goditjen e të mbyturit.¹⁰⁷

Mbytja me gabim është dy lloje:

1. Gabim në qëllim është atëherë kur personi gjuan me armë duke menduar se është gjahu, ndërsa i goditur del njeriu, kur shtie me armë duke menduar se e gjuan armikun e tij e pastaj del se ishte musliman.

¹⁰⁵. Transmeton Ahmedi dhe as-habu sunen me përjashtim të Tirmidhiut, marrur nga ibn Omeri

¹⁰⁶. Dr. Vehbe Ez-Zuhejli “El Fikhul Islamij ve ediletuhu”, 6/234.

¹⁰⁷. Prof. Jusuf Zimeri , vep, cit. f. 28.

2. Gabim në veprim është kur gjuan një njeri tjetër dhe e godet tjetrin ose kur gjuan në kafshë, ndërsa e godet njeriun.

Pavarësisht se për cilin lloj të gabimit kemi të bëjmë, për gabimin në qëllim apo në veprim, atëherë kur kryhet vepra penale e mbytjes me gabim, pasojat janë të njëjta.

SANKSIONET (MASAT NDËSHKIMORE) E VEPRËS PENALE SIPAS SHERIATIT

Sa u përket sanksioneve që parashihen për veprën penale (vrasjen) dhe me të cilën atakohet jeta e njeriut, kjo është një lëmi e gjerë me ç`rast do të përkufizohemi me theks të veçantë rreth sanksioneve që parashihen për veprën penale (për vrasjen). Pra, çka janë sanksionet penale sipas botë-kuptimit të së drejtës së sheriatit?

Ata definoen si:

*“Masa ndëshkuese që ekzekutohet me rrahje (edhe atë me shkop druri apo me kamxhik), amputimi, gurëzimi apo me vrasje.”*¹⁰⁸

Një ndër juristët me famë në jurisprudencë islame, dr. Muhamed ebu-Zehra, masat sanksionuese i definoen si: *“Shkaktim i vuajtjeve të legjitimuara sipas sheriatit me qëllim të mbrojtjes nga pasojat e dëmshme që mund të shkaktohen nga aktiviteti kriminal i kriminelëve.”*¹⁰⁹

Varësisht nga aktiviteti kriminal dhe vepra penale të kryera, të cilat meritojnë masa sanksionuese, ato ndahen në:

1. Vepra penale për të cilat janë të parapara masa sanksionuese të përcaktuara, që në terminologjinë e të drejtës së sheriatit njihen si *“el-haddu”*. Sanksionohen ato vepra penale, të cilat kryerësit të veprës nuk i lejohet as zbutja e tyre, as që mund të zëvendësohen ato, kjo për faktin se kemi shkelur një të drejtë të Zotit, që ndryshe njihet si *“interesi i përgjithshëm apo e drejtë shoqërore”*.

¹⁰⁸. Abdulla el-Gamidi “Sukut el-ukubat”, Medinë 1989, f. 22.

¹⁰⁹. Dr. Muhamed ebu Zehra “El-xherime vel ukube” Kajro 1970, f. 7.

2. Veprat penale që meritojnë masë sanksionuese që në terminologjinë e sheriatit njihen me emrin “*kisas*”- gjak-marrje. Vepër penale për të cilën ndëshkohet kryerësi i veprës është shkelja e të drejtës ekskluzive të individit, ndaj të cilit me të drejtë ngrihet padi.¹¹⁰ Pra, ai me këtë ka të drejtë të kërkojë që ai vetë apo familja e tij nga gjaku sikurse janë babai, biri, vëllai, xhaxhai etj., që ta shërojnë plagën që u është shkaktuar. Gjithqysh se ai ka të drejtë në kompensim për dëmin e shkaktuar material dhe atë psikik.

Këto sanksione ndryshe quhen edhe “*krime gjaku*”, parim ky që ngrihet nga ajeti kur'anor ku All-llahu xh.sh. thotë:

وَكَتَبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ
بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ وَالْأُذُنَ بِالْأُذُنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ
وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ ۚ فَمَن تَصَدَّقَ بِهِ ۖ فَهُوَ كَفَّارَةٌ لَّهُ ۚ
وَمَن لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٥٠﴾

“Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmaset ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e falë atë (hak-marrjen), ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti All-llahu, ata janë mizorë (të padrejtë).”¹¹¹

¹¹⁰. Dr. Kemal Xhevdet Mustafa, vep. cit. f. 26.

¹¹¹. El Maide, 45.

I - Llojet e sanksioneve penale

Dijetarët islam ndarjen e sanksioneve e ndërlidhin me atë se e drejta e kujt është shkelur.

-I- 1. Shikuar nga ky aspekt, kemi katër forma të të shkelurit e te drejtave edhe atë:

1. “E drejta ekskluzive e Zotit”, ku për këto vepra penale parashihen sanksione të përcaktuara “*el-had*”, për vepra penale të llojit vrasje, terrorizëm, konsumim alkooli etj.

2. E drejta individuale, ku si sanksion parashihen masa edukative p.sh., ndaj veprës penale -fyerje.

3. Të drejtat e përziera, ku më tepër dominon “e drejta e Zotit” p.sh., te vepra penale e shpifjes për prostitucion.

4. E drejtë e përzier, ku më tepër dominon e drejta e individit e cila është cenuar dhe shkelur, p.sh. te vrasja, vepër penale për të cilën parashihet masa sanksionuese “*el-kisas*”- gjakmarrje.

II - 2. Masat sanksionuese sipas të drejtës së sheriatit janë dy lloje:

1. Sanksione të përcaktuara dhe të përkufizuara në mënyrë të rreptë në masë, lloj dhe sasi, që të njëjtat janë të evidentuara në Kur`an dhe në thënie profetike - hadithe. Ato paraqiten në formë të “*el-kisasit*”- gjakmarjes dhe “*el-hudud*”- sanksioneve ndëshkuese të patjetërsueshme.

2. Sanksione të papërcaktuara që në terminologjinë e të drejtës së sheriatit njihen si “*et-te`azir*”- sanksione *diskreacionale*. Këto lloje të sanksioneve mund t'i shqiptojnë pushtetmbajtësit - udhëheqësit e shtetit apo ata që i autorizon kryetari. Atij i lihet e drejta ta përcaktojë llojin e dënimit dhe sasinë e sanksionimit, por pa e tejkaluar maksimumin e

paraparë për veprën penale, mirëpo pa zbritur nën minimumin e përshkruar për atë lloj të veprës penale. Këtë e bën duke u mbështetur në bindjen e tij juridike, duke marrë në konsideratë se cili sanksion ka efekt më pozitiv të zbatohet për çdo lloj vepre penale veç e veç, po ashtu edhe për çdo rast individual, me qëllim të vetëm që të arrihet efekti pozitiv pas zbatimit të sanksionit.¹¹²

Prof. A. Serraxhi llojin e dytë të sanksioneve penale e definon si “sanksion i cili nuk është përshkruar sikur për ato vepra kriminale për të cilat janë paraparë masa sanksionuese “el-had”- sanksione ndëshkuese të domosdoshme dhe “kisas”- gjakmarrje të parapara në Kur`an dhe Sunnet, por dallojnë nga ato në shumëçka, për atë se u janë lënë në duar që udhëheqësit të gjykojnë, varësisht nga rrethanat kohore dhe nga vendi”,¹¹³ por ato janë të rregulluara me klauzola të përgjithshme.¹¹⁴

II- Ndarja e sanksioneve penale

Sanksionet për vepra penale në legjislaturën penale islame, varësisht nga lidhshmëria e tyre ndahen në:

II- 1. Sanksione kryesor

Sanksion esencial është ai sanksion i ligjësuar për kriminalitet të caktuar, siç është rasti me “kisasin - gjakmarrjen”, për mbytyje...¹¹⁵etj.

¹¹². Dr. Abdulla El-gamidi, vep. cit. f. 26.

¹¹³. A Serraxh, “Kanunul ukubat”, Damask 1999, f. 13.

¹¹⁴. Dr. Muhammed Shilal el-Ani “Teshriul xhinai el-islami”, Irbid 1998, f. 35-40.

¹¹⁵. Prof. Jusuf Zimeri, vep. cit. f. 11.

II- 2. Sanksion alternativ - zëvendësues

Është dënimi i cili ekzekutohet në vend të sanksionit esencial i cili pengohet për ekzekutim për ndonjë arsyetim juridik, si p.sh. pagimi i dijes kur për shkak të dyshimit nuk mund të ekzekutohet dënimi i kisasit - gjakmarrjes, apo dënimi i papërcaktuar kur nuk mund të ekzekutohet sanksioni i hadit.¹¹⁶ Një realitet duhet pasur parasysh se edhe sanksioni alternativ në esencë është esencial, por zëvendëson ndonjë sanksion atëherë kur nuk mund të zbatohet sanksioni esencial.

II- 3. Sanksione pasuese

Këto sanksione janë dënime me të cilat goditet vepruesi në rrethin e tij familjar, pavarësisht se a është kryer procedura gjyqësore apo jo. Ky lloj sanksioni nuk ka nevojë për shqiptim dënimi, si p.sh. humbja e të drejtës së trashëgimisë për mbytësin.¹¹⁷

¹¹⁶. Prof. Jusuf Zimeri , vep. cit. f. 11.

¹¹⁷. Prof. Jusuf Zimeri , vep. cit. f. 11.

SANKSIONET E VEPRËS PENALE “MBYTJE ME QËLLIM”

Për veprën penale “mbytje me qëllim” në shariatin islam janë paraparë sanksione të ndryshme. Për veprën penale të mbytjes me qëllim, sanksionet për të janë:

- 1. Sanksione kryesorë,**
- 2. Sanksione alternative - zëvendësuese,**
- 3. Sanksione pasuese.**

1. SANKSIONET KRYESORË

Gjakmarrja (el - kisas)

Masa sanksionuese që parashihet për veprën penale vrasje me qëllim. Në terminologjinë e shariatit njihet me nocionin “el-kisas”- gjakmarrje që në kuptim etimologjik d.m.th. “të ndjekësh a të shkosh pas gjurmëve”, gjithashtu ka kuptimin e baraspeshës. Ndërsa në kuptimin terminologjik të së drejtës së shariatit islam d.m.th. “baraspesha mes krimit dhe dënimit apo ndryshe thënë, të ndëshkohet kriminelin në proporcion me krimin e bërë, të mbytet siç ka mbytur, të plagoset siç ka plagosur.”¹¹⁸

Ligjësimi i sanksionit të el-kisasit - gjakmarrjes është vërtetuar në Kur`an, në hadith dhe me konsensusin e dijetarëve islam.

All-llahu xh.sh. në Kur`an në lidhje me këtë thotë:

¹¹⁸. Prof. Muhamed Ebu zehra, vep. cit. f. 398.

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيَوةٌ يَأُولَى الْأَلْبَبِ لَعَلَّكُمْ

تَتَّقُونَ ﴿١٧٩﴾

“O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri-tjetrit).”¹¹⁹

Gjithashtu në një ajet tjetër, në po të njëjtën sure, All-llahu xh.sh. në lidhje me këtë thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِصَاصُ فِي الْقَتْلِ
الْحُرِّ بِالْحُرِّ وَالْعَبْدُ بِالْعَبْدِ وَالْأُنثَىٰ بِالْأُنثَىٰ ۖ فَمَنْ عُفِيَ لَهُ مِنْ
أَخِيهِ شَيْءٌ فَاتِّبَاعٌ بِالْمَعْرُوفِ وَأَدَاءٌ إِلَيْهِ بِإِحْسَنٍ ۚ ذَٰلِكَ
تَخْفِيفٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَرَحْمَةٌ ۚ فَمَنِ اعْتَدَىٰ بَعْدَ ذَٰلِكَ فَلَهُ

عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٨٠﴾

“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje: i liri për të lirin, rob për robin, femra për femrën. Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet (e atij që fal) kuptueshëm dhe shpagimi (nga dorasi) atij le t'i bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj. E kush tejkalon pas këtij (pajtimi), ai ka një dënim të hidhët.”¹²⁰

¹¹⁹. El Bekare, 179.

¹²⁰. El Bekare, 178.

Komentuesit e Kur'anit, mufesirët dhe teoricienët juridik pajtohen plotësisht se me këto ajete, padyshim i është dhënë e drejta familjes së të vërrit (trashëgimtarëve) që dënimin me vdekje për vrasje të qëllimshme mund ta ndërrojnë duke rënë në ujdi me dorasin për falje, duke kërkuar prej tij (dorasit) ose familjes së tij shpagimin e gjakut në mënyrë të lejuar. Ndërkaq, dorasi ose familja e tij, duhet të paguajë për të vërrin pa zvarritur. Shqiptimi i dënimin me vdekje nuk i është lejuar askujt përveç se imamit- gjykatësit.

Po ashtu me këtë përmbajtje vjen edhe ajeti tjetër kur'anor i kaptinës "El-Maide", ku All-llahu xh.sh. thotë:

وَكُتَبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ
بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ وَالْأُذُنَ بِالْأُذُنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ
وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ ۚ

"Ne u caktuam atyre në të (në Tëvrat) kundërmasat ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë..." ¹²¹

Lidhur me këtë, janë edhe thënie e Muhamedit a.s.:

من قتل له قتيل فهو بخير النظرين إما أن يفدي و إما أن يقتل

"Atij të cilit i vritet dikush është në mes dy zgjedhjeve: të kërkojë kompensimin e gjakut apo faljen pa kompensim, ose të kërkojë mbytjen e dorasit." ¹²² Gjithashtu kemi

¹²¹. El Maide, 45.

¹²². Nga Buhariu, Muslimi dhe Tirmidhiu.

edhe hadithin e transmetuar nga Ibni Abasi r.a. ku Muhamedi a.s. ka thënë:

ومن قتل عمدا فهو قود

“Kush është mbytur me qëllim, ndaj tij ekzekutohet mbytja.”¹²³

“Gjithashtu argument nga konsensusi islam është mendimi i të gjithë dijetarëve islam unanimsht, se personi i cili mbyt me qëllim, ndaj tij ekzekutohet sanksioni i kisasit.”

124

Islami ka paraparë dënim me vdekje - shpagim shpirt për shpirt, për secilin që argumentohet se është autor i vrasjes dhe dënim me ndëshkim të rëndë për vepra të këqija për secilin që vërtetohet se është shkaktar i këtij dëmi.

Rreth dënimit me vdekje, edhe ligjet e sotme bashkëkohore shekullare janë divergjente. Disa janë për dënimin me vdekje, sikurse është në shumë shtete të SHBA-së. Ajo që është me rëndësi të përmendim me këtë rast, sikurse kemi përmendur edhe më lartë dhe që bie ndesh me dënimin islam, është protokollin nr. 6 që i është shtuar Konventës Evropiane, është miratuar më 28 prill 1983 dhe ka hyrë në fuqi prej 1 marsit të vitit 1985, që ka sjellë një inovacion në legjislacionin penal: *“duke anuluar dënimin me vdekje, ndonëse kjo ishte objekt i një diskutimi të gjatë.”*¹²⁵

¹²³. Transmeton Revah ibn Shejbe dhe Is-hak ibn Rehavej në Sunenin e tyre nga Ibn Abasi.

¹²⁴. Prof. Jusuf Zimeri, vep cit. f. 19.

¹²⁵. Zejnullah Gruda, “Mbrotjtja ndërkombëtare e të drejtave të Njeriut”, boton Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2001, f. 68 & Arben Puto, “E Drejta ndërkombëtare Publike”, Tiranë 2002, f. 228.

Kushtet e “el-kisas”- gjakmarrjes

Që të mund të ekzekutohet sanksioni i kisasit – gjakmarrjes mbi kryerësin e veprës penale “mbytje me qëllim”, duhet plotësuar disa kushte që disa prej tyre kanë të bëjnë me dorasin, disa me mbytjen, disa me të mbyturin dhe disa me kujdestarin e të mbyturit.

Kushtet që kanë të bëjnë me dorasin:

1. Dorasi të jetë person juridik, moshë rritur dhe psikikisht i shëndoshë,

2. Dorasi të ketë pasur për qëllim mbytjen e personit,

3. Të mos ekzistojë dyshimi se vepra është kryer me qëllim,

4. Sipas hanefijve, kushtëzohet që kryerësi i veprës penale të ketë qenë i lirë, pa imponim nga ndonjë faktor tjetër,

5. Që mbytësi të jetë i moshës madhore. Nuk mund të aplikohet kisasi - gjakmarrja ndaj atij që është i mitur, ngase i tilli nuk konsiderohet *mukel-lef*.

6. Që mbytësi të jetë i aftë psikikisht. Nuk lejohet të aplikohet kisasi - gjakmarrja ndaj atij që është i çmendur, i matufosur, ngase edhe të tillët nuk konsiderohen mikel-lef. Po qe se ndodh që i sëmuri psikikisht nganjëherë kthjellet nga çmenduria dhe vjen në gjendje normale, e kur është në gjendje normale e mbyt dikë, atëherë ndaj njeriut të tillë aplikohet kisasi – gjakmarrja,

7. Që të mos i bashkëngjitet mbytësit në mbytje ndonjëri prej atyre që nuk mund të aplikohet kisasi - gjakmarrja. Nëse ndodh që i mituri, i çmenduri marrin pjesë në mbytje, ndaj tyre nuk zbatohet kisasi - gjakmarrja, por të tillët duhet ta paguajnë gjakun. Argument për këtë kemi hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë:

رفع القلم عن ثلاثة عن النائم حتى يستيقظ وعن المبتلى حتى يبرأ وعن الصبي حتى يكبر

“Lapsi është ngritur nga tre persona: nga i fjeturi deri sa të zgjohet, nga i çmenduri deri sa të shërohet dhe nga fëmija derisa të rritet.”¹²⁶

Kushtet që kanë të bëjnë me të mbyturin.

1. Kushtëzohet që gjaku i të mbyturit të ketë qenë i mbrojtur.

I mbyturi (i vrari) duhet të jetë musliman ose jomusliman, por që është i mbrojtur në shtetin islam. Po qe se ndodh që i mbyturi të jetë renegat, pabesimtar që nuk është nën mbrojtjen e shtetit islam, atëherë kisasi - gjakmarrja nuk vjen në shprehje që të aplikohet dhe as kurrfarë kompensimi.¹²⁷

2. Që i mbyturi të mos jetë pjesë e dorasit, që d.m.th. të mos jetë fëmija i dorasit. Nga kjo nënkuptohet se asnjëri nga prindërit nuk mbytet për fëmijën e tij. Këtë e vërteton hadithi i pejgamberit a.s. ku thotë:

لا يقاد الوالد بالولد

“Nuk mbytet prindi për fëmijë.”¹²⁸

3. Që i mbyturi të jetë i të njëjtit status me mbytësin në momentin e mbytjes. Sipas shumicës së dijetarëve islam, me përjashtim të hanefijve, nëse i liri e mbyt robin, muslimani e mbyt mosbesimtarin, nuk duhet të aplikohet kisasi - gjakmarrja.

¹²⁶. Transmeton Ahmed, këtë e vërteton edhe Hakimi, i nxjerrë nga ibn Habani.

¹²⁷. Flamur Sofiu, “Jurisprudenca islame” 4, Prishtinë 2001, f. 122.

¹²⁸. Transmeton Ahmed dhe Tirmidhiu. Imam Maliku thotë: “Që babai nuk vritet për të birin, nëse vrasja nuk është me qëllim. Por, nëse vrasja është me qëllim, si p.sh. ta mbys me litar apo ta therë me thikë, atëherë i ati vritet.”

Të këtillët mendimet e tyre i mbështesin në hadithet e pejgamberit a.s. ku ka thënë:

لا يقتل حر بعدٍ

“Nuk mbytet i liri për robin.”¹²⁹

Po ashtu ka thënë:

لا يقتل مسلم بكا فر

“Nuk mbytet muslimani për mosbesimtarin.”¹³⁰

Sipas hanefijve, këtë kusht nuk e kushtëzojnë dhe konsiderojnë që secili shtetas në shtetin islam, pa marrë parasysh statusin shoqëror, d.m.th. edhe nëse i liri e mbyt robin pa të drejtë, duhet të aplikohet kisasi - gjakmarrja ndaj tij të mbytet. Po ashtu sipas këtyre, edhe përkatësia fetare nuk pengon zbatimin e kisasit - gjakmarrjes, prandaj nëse muslimani bën krim ndaj jomuslimanit, i shqiptohet dënimi përkatës. Mendimin e tyre hanefijtë e mbështesin në kuptimin e përgjithshëm të ajeteve kur`anore që flasin për aplikimin e kisasit - gjakmarrjes, në sunnet dhe kijas.¹³¹

Kushtet që kanë të bëjnë me mbytjen

1. Dijetarët e medhhebit hanefij kushtëzuan që për ekzekutimin e sanksionit të kisasit - gjakmarrjes, mbytja patjetër të ketë ndodhur në mënyrë direkt e jo me shkak.

Kushtet që kanë të bëjnë me kujdestarin e të mbyturit

1. Kushtëzohet që kujdestari i të mbyturit që është përgjegjësi dhe e drejta e tij të kërkojë gjakun e të mbyturit, të jetë i ditur, i njohur e nuk mund të ekzekutohet sanksioni i mbytjes nëse kujdestari është i panjohur.

¹²⁹. Transmetohet nga Darekutni dhe Bejhekiu.

¹³⁰. Transmetohet Nga Ahmedi dhe Tirmidhiu.

¹³¹. Flamur Sofiu, vep. cit. f. 123.

Aplikimi i kisasit - gjakmarrjes

Për t'u plotësuar aplikimi i kisasit – gjakmarrjes, kushtëzohet të plotësohen tri kushte:

1. Që personi i cili ka të drejtën e gjakmarrjes - kisasit duhet të jetë i aftë psikikisht dhe moshë rritur. Nëse personi që ka të drejtën e gjakmarrjes - kisasit është fëmijë apo i sëmurë mendërisht, krimineli burgoset derisa fëmija ta arrijë moshën e pjekurisë apo i sëmuri psikik të shërohet. Pastaj ata kanë të drejtë të zgjedhin midis gjakmarrjes - kisasit, marrjes së dëmshpërblimit në para ose falje.

2. Që të pëlqehen të gjithë kujdestarët e të mbyturit në aplikimin e kisasit- gjakmarrjes. Nëse ndodh që ndonjëri prej kujdestarëve që ka të drejtë të kërkojë aplikimin e kisasit - gjakmarrjes është i mitur, i çmendur, nuk është prezent etj., duhet pritur që i mituri të hyjë në moshën e pjekurisë, i çmenduri derisa të vijë në gjendje normale, derisa ai që nuk është prezent të kthehet.

3. Që në aplikimin e kisasit - gjakmarrjes të mos pësojë dikush tjetër përveç dorasit. P.sh. nëse duhet të aplikohet dënimi i kisasit - gjakmarrjes ndaj ndonjë gruaje që është shtatzënë, në këtë rast nuk lejohet të ekzekutohet gruaje e tillë përderisa ajo të lindë dhe t'i japë gji fëmijës, ta plotësojë dhënien e gjirit. Pra, në këtë rast nuk lejohet të pësojë fëmija i cili gjendet në mitrën e nënës.

Në lidhje me këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë:

إذا قتلت المرأة عمدا لم تقتل حتى تضع ما في بطنها إن كانت
 حاملا و حتى تكفل ولدها و إذا زنت لم تر جم حتا تضع ما في
 بطنها إن كانت حاملا و حتا تكفل و لدها

“Nëse gruaja e mbyt me paramendim dikë, ajo nuk mbytet nëse është shtatzënë derisa të lind dhe derisa të përfundojë afati i përkujdesjes për fëmijën.”¹³²

Të vërtetuarit e kisasis - gjakmarrjes

Kisasi - gjakmarrja vërtetohet në këtë mënyrë:

1. Të miratuara nga vetë dorasi. Për këtë transmetohet se në kohën e Pejgamberit a.s. një njeri kishte ardhur te Pejgamberi a.s. me një njeri tjetër dhe iu kishte drejtuar Pejgamberit a.s. duke i thënë: “Ky njeri i cili është me mua ma ka mbytur vëllain tim”. Pejgamberi a.s. i tha: “Nëse ky nuk e pranon një gjë të tillë, atëherë ty të mbetet të sjellësh dëshmi.” Kur e pyeti Pejgamberi a.s. atë se a është e vërtetë ajo që e tha, ai u përgjigj se vërtetë e ka mbytur atë.”¹³³

2. Të dëshmuarit nga dy dëshmitarë. Për atë se duhet të sjell dy dëshmitarë për t’u vërtetuar kisasi - gjakmarrja. Kemi rastin që ka ndodhur në kohën e Pejgamberit a.s. kur njërin prej shokëve e kishin gjetur të mbytur, ndërsa Pejgamberi a.s. kërkoi nga kujdestarët e tij dy dëshmitarë të dëshmojnë se kush e ka mbytur atë.¹³⁴

Ekzekutimi i kisasis - gjakmarrjes

Mënyra dhe mjeti me të cilin ekzekutohet kisasi - gjakmarrja, te dijetarët islam ekzistojnë dy mendime:

1. Sipas shkollës juridike hanefite dhe hanbelite, në momentin kur duhet të ekzekutohet kisasi - gjakmarrja, ai duhet të ekzekutohet vetëm me shpatë, pavarësisht se me çfarë mjeti është kryer vepra penale. Këtë mendim e mbështesin në hadithin e Pejgamberit a.s. ku ka thënë:

¹³². Transmeton Ibn Maxhe.

¹³³. Flamur Sofiu, vep. cit. f. 126.

¹³⁴. Flamur Sofiu, vep. cit. f. 126.

لا قود إلا بالسيف

“Nuk ka mbytje, përveç se me shpatë.”¹³⁵

Po ashtu këta mendojnë se aplikimi i kisasit - gjakmarrjes për mbytje me shpatë është lehtësim dhe mbytje e shpejtë me pak mundime, këtë mendim e mbështesin në hadithin e Pejgamberit a.s. ku ka thënë:

إذا قتلتم فأحسنوا القتلة وإذا ذبحتم فأحسنوا البحة

“Kur të mbytni, mbytni në mënyrën më të mirë dhe kur të therni, therni në mënyrën më të mirë.”¹³⁶

2. Sipas shkollës juridike malikite dhe shafiite, sanksioni i kisasit - gjakmarrjes mbi kryerësin e veprës, ekzekutohet në atë mënyrë që ai e ka kryer krimin e tij, mirëpo nëse kujdestari i të mbyturit pajtohet që ekzekutimi i kisasit të bëhet me armë, atëherë lejohet...

Kur nuk mund të aplikohet kisasi – gjakmarrja?

Kisasi - gjakmarrja nuk mund të aplikohet në këto raste:

1. Vdekja e dorasit

Nëse vdes dorasi ose mbytet nga dikush tjetër, ndaj të tillit nuk mund të aplikohet kisasi - gjakmarrja. Mirëpo dije-tarët islam kanë mendime të ndryshme rreth asaj se a duhet të shpaguehet gjaku nga pasuria e dorasit, edhe pse ai nuk është më gjallë.

Sipas hanefijve dhe malikijve, nëse bie kisasi – gjakmarrja me vdekjen e dorasit, nuk obligohet pagimi i gjakut - *dijes*

¹³⁵. Transmeton Ibni Maxheh.

¹³⁶. Transmeton Muslimi në Sahihun e tij marrë nga Sheda ibn Evsi.

nga pasuria e dorasit, sepse kisasi - gjakmarrja është obligim esencial e nëse bie ky obligim, atëherë kujdestari i të mbyturit nuk ka të drejtë të marrë *dije*, vetëm në pajtimin e dorasit.

Kurse sipas mendimit të hanbelijve, nëse bie kisasi - gjakmarrja me vdekjen e dorasit, atëherë kujdestari i të mbyturit ka të drejtë të zgjedh në marrjen e *dijes*. Nëse vrasësi vdes, atëherë kujdestarit të të vrarit i mbetet vetëm dëmshpërblimi në para. Arsyeja është se gjakmarrja - kisasi kryhet vetëm mbi kriminelin dhe jo mbi dikë tjetër, bazuar në ajetin kur'anor ku All-llahu xh.sh. thotë:

وَمَنْ قُتِلَ مَظْلُومًا فَقَدْ جَعَلْنَا لَوْلِيَّهِ سُلْطٰنًا فَلَا

يُسْرِفُ فِي الْقَتْلِ إِنَّهُ كَانَ مَنْصُورًا

“...e kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos e kalojë kufirin në mbytje derisa ai është i ndihmuar (prej Zotit).”¹³⁷

2. Falja e gjakut

Sipas sheriatit islam, falja e gjakut jo vetëm që është e lejuar, por ka më shumë prioritet sesa ekzekutimi i kisasit - gjakmarrjes. Në lidhje me këtë, All-llahu xh.sh. thotë:

فَمَنْ عَفَىٰ لَهُ مِنْ أَخِيهِ شَيْءٌ فَاتَّبَاعٌ بِالْمَعْرُوفِ وَأَدَاءٌ

إِلَيْهِ بِإِحْسَانٍ ذَلِكَ تَخْفِيفٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَرَحْمَةٌ

¹³⁷. El Isra, 33.

”Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet (e atij që fal) kuptueshëm dhe shpagimi (nga dorasi) atij le t'i bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj.” ¹³⁸

Për faljen kemi edhe shumë argumente nga sunneti i Pejgamberit a.s. e që në këtë rast do të kishim përmendur hadithin e transmetuar nga Enesi r.a. ku ka thënë:

عن أنس قل ما رفع إلى رسول الله صلى الله عليه وسلم أمر فيه القصاص إلا أمر فيه بالعفو

“Nuk i është paraqitur ndonjë lëndë Pejgamberit a.s. që ka pasur kisas - gjakmarrje, e të mos ketë urdhëruar për falje.” ¹³⁹

Sipas hanefijve, me faljen e gjakut nënkuptohet falja e aplikimit të kisasit - gjakmarrjes pa kurrfarë kompensimi, ndërsa sipas shafijve dhe hanbelijve nënkuptohet falja e aplikimit të kisasit - gjakmarrjes me mundësi të kompensimit të gjakut.

Të drejtën për faljen e gjakut e kanë të gjithë trashëgimtarët prej meshkujve dhe femrave. Po ashtu për t'u falur gjaku, duhet plotësohen dy kushte:

a) falësi të jetë moshë rritur dhe i aftë psikikisht dhe

b) falja të bëhet nga ata që kanë të drejtë të kërkojnë aplikimin e kisasit - gjakmarrjes.

Shënim

Të gjithë dijetarët islam janë unanim që nëse dikush e mbyt dikë në *Harem*¹⁴⁰, i tilli lejohet të mbytet në *Harem*. Po qe se ndodh që dikush mbyt dikë jashtë *Haremit* dhe i tilli strehohet në *Harem*, sipas imam Malikut r.a., ai duhet të

¹³⁸. El Bekare, 178.

¹³⁹. Transmeton Ahmedi.

¹⁴⁰. Harem është për qëllim Qabeja në Mekë.

mbytet në *Harem*, ndërsa sipas imam Ebu Hanifes r.a. dhe imam Ahmedit r.a. nuk duhet të mbytet në *Harem*, por duhet t'i ngushtohen rrethanat e jetës, d.m.th. të mos bëhet kurrfarë shitblerje me të derisa ai të detyrohet të dalë prej *Haremit* e pastaj të mbytet jashtë *Haremit*.

2. SANKSIONI ALTERNATIV - ZËVENDËSUES

Kur bie ekzekutimi i sanksionit esencial të kisasit - gjakmarrjes për ndonjë arsye që e përmendëm më parë, atëherë mbi kryerësin e veprës mund të ekzekutohen edhe dy sanksionet tjera, ato janë:

1. Pagimi i gjakut 'ed-dije',
2. Sanksion i papërcaktuar 'et-ta'zir'.

1. Pagimi i gjakut 'ed-dije'

Me nocionin ed-dije nënkuptojmë pagimin e gjakut, respektivisht pasurinë të cilën e paguan dorasi ose familja e tij për kujdestarin e të mbyturit si kompensim për krimin e bërë. Ky nocion në terminologjinë e shariatit islam përdoret në kuptimin e dëmshpërblimit për mbytje.

Pagimi i gjakut është i obligueshëm dhe ky obligim vërtetohet nga argumentet kur'anore, nga sunneti i Pejgamberit a.s. si dhe nga konsensusi i dijetarëve islam.

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

وَدِيَّةٌ مُّسَلَّمَةٌ إِلَىٰ هَلِهِ

”...dhe shpagimin (e gjakut) t’ia dorëzojë familjes së tij.”¹⁴¹

Ky ajete kur’anor edhe pse flet për mbytjen me gabim, dijetarët islam janë unik për obligueshmërinë e pagimit të gjakut në mbytjen me qëllim në gjendje kur bie sanksioni esencial kisasi - gjakmarrja.

Nga hadithet e Pejgamberit a.s. ekzistojnë shumë argumente të cilat e vërtetojnë obligueshmërinë e pagimit të gjakut, ne do të përmendim vetëm këtë hadith ku pejgamberi a.s. thotë:

إن في النفس الدية ما ءة من الإبل

“Vërtetë për çdo shpirt paguhet gjaku (dije) me 100 deve.”¹⁴²

Lloji i pasurisë për pagimin e gjakut dhe sasia

Sipas mendimit të imam Ebu Hanifes dhe imam Malikut, pagimi i gjakut është obligim që të paguhet në njërën nga këto lloje të pasurisë: deve, ari ose argjend. Nga cilado pasuri që paguhet, *dija* është e vlefshme. Argument i kësaj është hadithi i pejgamberit a.s. ku thotë:

إن في النفس الدية ما ءة من الإبل

“Vërtetë për çdo shpirt paguhet gjaku (dije) me 100 deve.”¹⁴³

Gjithashtu kemi rastin e Omerit r.a. kur atyre që kishin ar ua kishte obliguar që *dijen* ta paguajnë me ari dhe atë me sasi prej 1000 dinarë, kurse me argjend 10000 dërrhem.

¹⁴¹. En Nisa, 92.

¹⁴². Transmeton Ahmedi dhe as-habu sunen me përjashtim të Tirmidhiut, marrë nga ibn Omeri.

¹⁴³. Transmeton Ahmedi dhe as-habu sunen me përjashtim të Tirmidhiut, marrë nga ibn Omeri.

Kurse sipas mendimit të imam Shafiut, esenca e pagimit të gjakut duhet të bëhet patjetër në deve.

Pagimi i gjakut është dy lloje:

1. Pagim i rëndë.

Ky lloj pagimi është i obligueshëm për mbytjen me qëllim dhe për mbytjen si me qëllim. Vlera e saj është 100 deve dhe kjo *dije* paguhet vetëm me deve, kurse sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe Ebu Jusufit kompletohet me këtë përbërje:

1. 25 deve njëvjeçare,
2. 25 deve dyvjeçare,
3. 25 deve trevjeçare,
4. 25 deve katërvjeçare.

Këtë mendim Ebu Hanifja dhe Ebu Jusufi e mbështesin në hadithin e Pejgamberit a.s. me ç'rast ka thënë:

إن في النفس الدية ما ءة من الإبل

“Vërtetë për çdo shpirt paguhet gjaku (dije) me 100 deve.”¹⁴⁴

Kurse sipas mendimit të imam Muhamedit, kjo *dije* përbëhet:

1. 30 deve trevjeçare,
2. 30 deve katërvjeçare,
3. 40 deve që janë mbarse.

Imam Muhamedi mendimin e tij e mbështet në hadithin e Pejgamberit a.s. ku ka thënë:

¹⁴⁴. Transmeton Ahmedi dhe as-habu sunen me përjashtim të Tirmidhiut, marrë nga ibn Omeri.

ألا وإن كل قتل خطأ العمد قتيل السوط والعصا وفيه مائة من الإبل منها أربعون في بطونهما أو لادها

“Vrasje me si me qëllim konsiderohet mbytje me kamxhik dhe shkop e për të paguhen njëqind deve e 40 krerë me mbarset e tyre në bark...”¹⁴⁵

2. Pagim i lehtë

Ky lloj pagimi obligohet për mbytje me gabim. Për dallim nga *dija* e rëndë, kjo *dije* ndahet në pesë, ato janë:

1. 20 deve njëvjeçare meshkuj,
2. 20 deve njëvjeçare femra,
3. 20 deve dyvjeçare,
4. 20 deve trevjeçare,
5. 20 deve katërvjeçare.

Pagimi i lehtë i *dijes* mund të bëhet edhe me pasuri tjera siç janë:

1. 200 lopë,
2. 1000 dele,
3. 1000 ari,
4. 10000 argjend derhem sipas hanefijve, kurse sipas të tjerëve 12000 derhem,
5. 200 kostume - rrobe.

Sipas mendimit të të gjithë dijetarëve islam, pagimi i gjakut në mbytje me qëllim bëhet nga pasuria e dorasit.

2. Sanksioni i papërcaktuar - et-ta`zir

Nëse bie ekzekutimi i sanksioni të kisasit - gjakmarrjes në mbytje me qëllim, atëherë sanksioni i papërcaktuar është sanksioni zëvendësues i cili e zëvendëson kisasin-

¹⁴⁵. Transmeton Ahmedi dhe as-habu sunen me përjashtim të Tirmidhiut, marrë nga ibn Omeri.

gjakmarren, por megjithëkëtë, dijetarët islam nuk janë unik në mendimet e tyre nëse sanksioni zëvendësues është i obligueshëm apo vetëm i lejuar.

Sipas mendimit të imam Malikut, sanksioni zëvendësues është i obligueshëm, sipas tij ky sanksion do të ishte 100 shkopinj (kamxhik) dhe burgosja për një vit. Këtë mendim e mbështetin në një transmetim të dobët nga Omeri r.a.

Sipas shumicës së dijetarëve islam, sanksioni i papërcaktuar nuk është i obligueshëm, i domosdoshëm, por kjo çështje mbështetet te udhëheqësi islam nëse ai e sheh të arsyeshme, atëherë mund ta sanksionojë kryerësin i veprës. Ky sanksion mund të jetë me rrahje, privim nga liria etj., varësisht nga nevoja si e sheh udhëheqësi islam.¹⁴⁶

3. SANKSIONI PASUES

Sanksioni pasues është:

1. Humbja e të drejtës së trashëgimisë.

Argument për këtë kemi hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë:

ليس للقا نل شيء من الميراث

*“Mbytësi nuk trashëgon asgjë nga pasuria.”*¹⁴⁷

2. Humbja e të drejtës së testamentit.

Argument për këtë kemi hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë:

لا وصية لقا نل

¹⁴⁶. Prof. Jusuf Zimeri, vep. cit. f. 24.

¹⁴⁷. Transmeton Ebu Davudi, marrë nga Amr ibn Shuajbi, nga babai i tij dhe gjyshi.

“Nuk ka testament për dorasin.”¹⁴⁸

Sipas mendimit të Ebu Hanifes, mbytjet me qëllim, mbytjet si me qëllim dhe mbytjet me gabim e pengojnë dorasin që ta trashëgojë nëse plotësohen këto kushte:

1. Që mbytja të jetë direkt,
2. Që dorasi të jetë person juridik, moshë rritur dhe psikikisht i shëndoshë.
3. Që mbytja në mbytjen me qëllim dhe si me qëllim të jetë me armiqësi, d.m.th. të mos jetë në mbrojtje, sepse atëherë nuk pengohet nga trashëgimia.

Të njëjtat kushte vlejnë edhe për pengimin nga testamenti.¹⁴⁹

¹⁴⁸. E ka nxjerrë Darekutni dhe Bejhekiu, marrë nga Ali ibn Talibi.

¹⁴⁹. Prof. Jusuf Zimeri, vep. cit. f. 25.

SANKSIONI I VEPRËS PENALE “MBYTJA SI ME QËLLIM”

Gjithashtu sanksioni i veprës penale ‘mbytja si me qëllim’ ndahet në:

- 1. Sanksion kryesorë,**
- 2. Sanksion zëvendësues,**
- 3. Sanksion pasues.**

1. Sanksioni kryesorë

Sanksion esencial i veprës penale ‘mbytje si me qëllim’ në shariatën islam është pagimi i gjakut (*dije*).

Pagimi i gjakut (*dije*).

Për dallim nga sanksioni i veprës penale ‘mbytje me qëllim’, që pagimi i gjakut është sanksion zëvendësues, në veprën penale ‘mbytje si me qëllim’, sanksioni i pagimit të gjakut është sanksioni esencial edhe atë për arsye se të gjithë dijetarët islam janë unik se në veprën penale ‘mbytje si me qëllim’ nuk ekziston sanksion i gjakmarrjes el-kisas. Argument e kanë hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë:

ألا وإن كل قتل خطأ العمد أو شبه العمد قتل السوط والعصا
الحجر مائة من الإبل

“Vërtetë çdo mbytje si me qëllim konsiderohet po ashtu mbytje me kamxhik, shkop dhe gurë, e për të paguhen njëqind deve.”¹⁵⁰

¹⁵⁰. Transmeton Ahmedi dhe as-habu sunen me përjashtim të Tirmidhiut, marrë nga ibn Omeri.

Dispozita e pagimit të gjakut në mbytje si me qëllim janë të njëjta sikurse te mbytja me qëllim, me përjashtim se te vepra penale ‘mbytje me qëllim’ pagimi i gjakut bëhet nga të afërmit e dorasit e që quhet ed-dijetul akileh edhe paguhet me afat prej tri viteve e jo nga pasuria e dorasit siç është vepra penale ‘mbytje me qëllim’.

Argument për këtë është hadithi i Pejgamberit a.s. të cilin e transmeton Ebu Hurerja r.a. ku thotë:

اَقْتَنَلْتُ امْرَأَتَانِ مِنْ هُدَيْلٍ فَرَمْتُ إِحْدَاهُمَا الْآخَرَى بِحَجَرٍ فَقَتَلْتُهُمَا وَمَا فِي بَطْنِهَا فَاخْتَصَمُوا إِلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَضَى أَنَّ دِيَةَ جَنِينِهَا غُرَّةَ عَبْدٍ أَوْ وَلِيدَةٍ وَقَضَى أَنَّ دِيَةَ الْمَرْأَةِ عَلَى عَاقِلَتِهَا

“Në kohën e Pejgamberit a.s. ishin rrahur dy gra të fisit hudhejl dhe njëra prej tyre gjuajti me një gurë dhe e mbyti tjetrën dhe fëmijën në barkun e saj. Pejgamberi a.s. gjykoj që për fëmijën të paguaj një gurr-rre (dhjetë deve), kurse për gruan të paguaj një dije nga të afërmit e saj.”

2. Sanksioni zëvendësues

Sanksionin zëvendësues në raste kur bie pagimi i gjakut për ndonjë arsye, atë mund ta zëvendësojë sanksioni i papërcaktuar. Sipas shumicës së dijetarëve islam, kjo çështje i lihet në gjykim sunduesit të muslimanëve, nëse ai e sheh të arsyeshme që dorasin ta sanksionojë, atëherë e ekzekuton sanksionin që ai e parasheh. Dispozitat me këtë rast janë të ngjashme sikurse te vepra penale ‘mbytje me qëllim’ që i theksuam më lartë.

3. Sanksioni pasues

Sanksioni pasues te vepra penale ‘mbytje si me qëllim’ është humbja e të drejtës së trashëgimisë dhe e testamentit, me të njëjtat dispozita që u theksuan te sanksioni i mbytjes me qëllim.

SANKSIONET E VEPRËS PENALE “MBYTJE ME GABIM”

Pasojat e mbyttjes me gabim janë të përcaktuara në Kur'an me ç'rast All-llahu xh.sh. thotë:

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ أَنْ يَقْتُلَ مُؤْمِنًا إِلَّا خَطَاً وَمَنْ قَتَلَ مُؤْمِنًا خَطَاً فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَدِيَّةٌ مُسْلَمَةٌ إِلَى أَهْلِهِ إِلَّا أَنْ يَصَّدَّقُوا فَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمٍ عَدُوٍّ لَكُمْ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ فَدِيَّةٌ مُسْلَمَةٌ إِلَى أَهْلِهِ وَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَصِيَامُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ تَوْبَةً مِنَ اللَّهِ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿٩٢﴾

”Asnjë besimtari nuk i është i lejuar të mbysë besimtarin tjetër, përpos gabimisht. E kush e mbyt gabimisht një besimtar, ai është i obliguar ta lirojë një rob besimtar dhe shpagimin (e gjakut) t’ia dorëzojë familjes së tij, përpos në qoftë se ia falin (familja gjakun). Në qoftë se ai (i mbyturi gabimisht) është besimtar, por i takon popullit që është armik i juaj, atëherë është obligim vetëm lirimi i

një robi besimtar. Në qoftë se ai (i mbyturi) është nga ai popull që keni marrëveshjen me të, atëherë është obligim shpagimi (i gjakut) që i dorëzohet familjes së tij dhe lirimi i një robi besimtar. E kush nuk ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjërojë dy muaj rresht si pendim (i pranuar) ndaj All-llahut. All-llahu është më i dijsmi, ligjdhënësi më i drejtë.”.¹⁵¹

Sipas konsensusit të dijetarëve islam, te mbytja me gabim nuk ekziston sanksioni i kisasit - gjakmarrjes, por për këtë vepër penale parashihen vetëm dy lloje të sanksioneve, ato janë:

1. Sanksioni esencial që është:
 - a) pagimi i gjakut dhe
 - b) kefareti.
2. Sanksioni pasues që është:
 - a) pengimi i trashëgimisë dhe
 - b) testamenti.

1. Sanksionet esenciale

a) Pagimi i gjakut

Pagimi i gjakut te vepra penale ‘mbytje me gabim’ është sanksion esencial, kurse sasia e saj është ngjashëm me pagimin e gjakut te vepra penale ‘mbytje me apo si me qëllim’, d.m.th. 100 deve. Ligjësimin e këtij sanksioni e vërteton ajeti kur`anor ku All-llahu xh.sh. thotë:

¹⁵¹. En Nisa, 92

وَمَنْ قَتَلَ مُؤْمِنًا خَطَاً فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَدِيَةٌ مُسَلَّمَةٌ
 إِلَى أَهْلِهِ إِلَّا أَنْ يَصَّدَّقُوا فَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمٍ عَدُوٍّ لَكُمْ وَهُوَ
 مُؤْمِنٌ فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ
 وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ فَدِيَةٌ مُسَلَّمَةٌ إِلَى أَهْلِهِ وَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ فَمَنْ
 لَمْ يَجِدْ فَصِيَامُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ تَوْبَةً مِّنَ اللَّهِ وَكَانَ اللَّهُ
 عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿٩٢﴾

“E kush e mbyt gabimisht një besimtar, ai është i obliguar ta lirojë një rob besimtar dhe shpagimin (e gjakut) t'ia dorëzojë familjes së tij, përpos në qoftë se ia falin (familja gjakun). Në qoftë se ai (i mbyturi gabimisht) është besimtar, por i takon popullit që është armik i juaji, atëherë është obligim vetëm lirimi i një robi besimtar. Në qoftë se ai (i mbyturi) është nga ai popull që keni marrëveshjen me të, atëherë është obligim shpagimi i (gjakut) që i dorëzohet familjes së tij dhe lirimi i një robi besimtar. E kush nuk ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjërojë dy muaj rresht si pendim (i pranuar) ndaj All-llahut. All-llahu është më i dijshti, ligjdhënësi më i drejtë.” ¹⁵²

Kurse sasia përcaktohet nga hadithi i Pejgamberit a.s. ku thotë:

فِي دِيَةِ الْخَطَا عَشْرِينَ بَيْتَ مَخَاضٍ وَعَشْرِينَ بَنِي مَخَاضٍ
 ذُكُورًا وَعَشْرِينَ بَيْتَ لُبُونٍ وَعَشْرِينَ جَذَعَةً وَعَشْرِينَ حَقَّةً

¹⁵². En Nisa, 92.

“Pagimi i gjakut në veprën penale me gabim është 20 deve njëvjeçare meshkuj, 20 deve njëvjeçare femra, 20 deve dyvjeçare, 20 deve trevjeçare dhe 20 deve katërvjeçare.”¹⁵³

Të gjithë dijetarët islam janë unik se dija e mbytjes me gabim, paguhet nga familja e mbytësit në një afat prej tre viteve.

b) Kefareti

All-llahu xh sh. në lidhje me këtë në Kur'an thotë:

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ أَنْ يَقْتُلَ مُؤْمِنًا إِلَّا خَطَاً وَمَنْ قَتَلَ مُؤْمِنًا خَطَاً فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَدِيَّةٌ مُسْلَمَةٌ إِلَى أَهْلِهِ إِلَّا أَنْ يَصَّدَّقُوا فَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمٍ عَدُوٍّ لَكُمْ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ فَدِيَّةٌ مُسْلَمَةٌ إِلَى أَهْلِهِ وَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَصِيَامُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ تَوْبَةً مِّنَ اللَّهِ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا

“Asnjë besimtari nuk i është i lejuar të mbyisë besimtarin tjetër, përpos gabimisht. E kush e mbyt gabimisht një besimtar, ai është i obliguar ta lirojë një rob besimtar dhe shpagimin (e gjakut) t'ia dorëzojë familjes së tij, përpos në

¹⁵³. Transmeton Ahmed, Bezari dhe Bejhekiu.

*qoftë se ia falin (familja gjakun). Në qoftë se ai (i mbyturi gabimisht) është besimtar, por i takon popullit që është armik i juaji, atëherë është obligim vetëm lirimi i një robi besimtar. Në qoftë se ai (i mbyturi) është nga ai popull që keni marrëveshjen me të, atëherë është obligim shpagimi i (gjakut) që i dorëzohet familjes së tij dhe lirimi i një robi besimtar. E kush nuk ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjërojë dy muaj rresht si pendim (i pranuar) ndaj All-llahut. All-llahu është më i dijshti, ligdhënësi më i drejtë.*¹⁵⁴

Nga ky ajet kura`nor i cili flet edhe për mbytjen me gabim, në mënyrë të qartë na bëhet me dije se kefareti është obligim me rastin kur ekziston mbytja me gabim në këto raste:

1. Nëse e mbyt besimtarin nga mesi i besimtarëve, d.m.th. në shtetin islam, atëherë mbytësi obligohet me kefaret, që është lirim i një robi besimtar, kurse familja e tij me pagimin e gjakut.

2. Kur mbyt një besimtar i cili jeton në mesin e jobesimtarëve e që nuk e di se është besimtar, atëherë vrasësi obligohet me kefaret, por gjakun nuk e paguan.

3. Kur mbyt një mosbesimtar i cili gjendet në mesin e muslimanëve me marrëveshje dhe garanci, atëherë mbytësi obligohet me kefaret, kurse familja e tij me pagimin e gjakut.

Në rastet kur mbytësi nuk ka mundësi për lirim të robit për ndonjë arsye, atëherë obligohet me agjërimin e dy muajve pa ndërprerë.

2. Sanksioni pasues

Sanksioni pasues në veprën penale mbytje me gabim është pengimi në trashëgimi dhe në testament, ngjashëm me sanksionin pasues të mbytja me dhe si me qëllim.

¹⁵⁴. En Nisa, 92.

SANKSIONET (MASAT NDËSHKIMORE) NË LIGJET TJERA

Sanksioni në kuptimin penal-juridik nënkupton “*zbati- min e masave të detyrueshme ndaj shkelësit të normave për shkak të veprës së kryer me shkeljen e normës penale-juridi- ke.*”¹⁵⁵ SANKSIONI është masë e detyrueshme të cilën krye- rësit ia shqipton gjykatësi nëpërmjet vendimit gjyqësor të detyrueshëm shtetëror, me ligj i përcaktuar si reaksion për veprën e kryer. Përmbytja e saj është marrja apo kufizimi i disa të drejtave të kryerësit të veprës, shërimi i tij i detyrue- shëm ose trajtimi i detyrueshëm paraqitet në formë të dëni- mit, *masa alternative, masa sigurie dhe masa edukuese* (të rezervuara për fëmijë të mitur).¹⁵⁶ Për termin e sanksionit penal-juridik janë të rëndësishëm elementet vijuese:

e para, se ajo është ***pasojë juridike*** që paraqitet për kryerësin për shkak të kryerjes së veprës penale;

e dyta, sanksioni penal-juridik është masë e detyruar që e shqipton gjykatësi dhe

e treta, sanksioni penal-juridik përbëhet *në marrjen ose në kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të kryerësit ose shërimin e detyruar ose trajtimin në liri.*

Llojet e sanksioneve në përgjithësi:

Meqë kryerësit e veprave penale dallojnë për nga per- sonaliteti i tyre dhe nga kushtet objektive në të cilat kanë jetuar dhe të cilat në një masë kanë determinuar kriminali-

¹⁵⁵. Vllado Kambovski, “E drejta penale”, pjesa e përgjithshme, Shkup 2007, f. 429.

¹⁵⁶. Vllado Kambovski, vep. cit. f. 429.

tetin, është treguar më se e domosdoshme që të parashikohen disa lloje të sanksioneve penale që të mund të luftohet kriminaliteti me sukses. Andaj që nga fillimi i shekullit XX në vend të monizmit, në të drejtën penale inaugurohet pluralizmi i sanksioneve penale-juridike, parashihen shumë lloje të sanksioneve penale. Kësisoj, tani pluralizmi i sanksioneve penale është një ndër karakteristikat themelore të legjislacioneve penale të shteteve bashkëkohore.

Pa marrë parasysh dallimet terminologjike, në të drejtat penale të shteteve bashkëkohore kryesisht njihen këto pesë lloje të sanksioneve penale: **dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese, masat siguruese, masat edukative, dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqësore.**¹⁵⁷

Dënimi edhe sot ka mbetur sanksion themelor në të drejtën penale të të gjitha shteteve dhe si i tillë më së shpeshti shqiptohet ndaj kryerësve të veprës penale. Pothuajse të gjitha legjislacionet penale bashkëkohore i njohin këto lloje të sanksioneve penale. Mirëpo, duhet theksuar se meqë disa prej masave siguruese në brendinë e tyre janë sanksione penale me të cilat kryerësve të veprave penale të shteteve të Evropës Perëndimore, këto lloje të sanksioneve konsiderohen si dënime plotësuese. Kështu ka vepruar edhe kodi penal i Kosovës (neni 54, f. 19).

Sipas Kodit Penal të Kosovës, ndaj kryerësve të veprave penale, bashkë me dënimin kryesor, mund tu shqiptohen dënimet plotësuese në rastet kur vetëm dënimi kryesor nuk mund të ushtrojë funksionin e luftës kundër kriminalitetit dhe vrasjeve.

¹⁵⁷ Dr. Ismet Salihu, "Edrejta penale", pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2003, f. 426.

Sanksionet penale në të drejtën penale të Kosovës:

Ngjashëm me të drejtën penale të shteteve të Evropës Perëndimore dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e drejta penale e Kosovës e përvetëson sistemin pluralist të sanksioneve penale. Në nenin 3 të Kodit Penal të Kosovës janë paraparë katër lloje të sanksioneve penale.¹⁵⁸ Këto janë:

1. dënimet kryesore,
2. dënimet alternative,
3. dënimet plotësuese dhe
4. vërejtja gjyqësore.

1. Dënimet kryesore shqiptohen ndaj personave madhorë të cilët janë penalisht të përgjegjshëm për veprë penale të kryer (të ketë kuptuar rëndësinë e veprës së vet dhe të ketë pasur aftësi t'i kontrollojë sjelljet e veta dhe që veprën penale ta ketë kryer me fajin e tij me dashje apo nga pakujdesia).

2. Dënimet alternative janë lloj i posaçëm i masave parapenale, me të cilat në të gjitha rastet e mundshme, kryerësi i veprës penale në vend që të dënohet me burgim nga ana e gjykatës, atij i tërhiqet vërejtja dhe njëherësh i caktohen obligime të cilat duhet t'i përmbush brenda afatit të caktuar. Nëse nuk i përmbush obligimet e caktuara nga gjykata, dënimet alternative mund të revokohen dhe të shndërrohen në dënim me burgim.

3. Dënimet plotësuese janë të karakterit sekondar dhe i plotësojnë dënimet kryesore. Sipas kodit penal, këto dënimet gjithherë mund të shqiptohen vetëm së bashku me dënimin kryesor. Gjer me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Kosovës, shumica dërmuese e nëntë llojeve të dënimeve

¹⁵⁸. Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, UNMIK/RREG/2003/25 f. 2,-.

plotësuese që parashihi me kodin penal, janë konsideruar si masa siguruese.

4. Vërejtja e gjykatës. Me këtë lloj të sanksionit penal, kryerësit të veprës penale gjykata ia tërheq vërejtjen dhe e qorton, njëherësh ia bën me dije se nëse sërish kryen vepër penale, do t'i shqiptohet lloji i sanksionit penal më i rëndë.

Për vepra penale sipas Kodit Penal të Kosovës kemi pesë lloje të dënimeve (neni 36, 41 dhe 54). Këto janë:

- dënimi me burgim afatgjatë,
- dënimi me burgim,
- dënimi me gjobë,¹⁵⁹
- dënimet alternative,¹⁶⁰
- dënimet plotësuese.¹⁶¹

Sanksionet penale sipas Kodit Penal të Shqipërisë

Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, me plotësimet e ndryshme nga viti 2001, parasheh këto lloje të sanksioneve penale: **dënimet kryesore, dënimet plotësuese, masat mjekësore dhe masat edukuese.**¹⁶²

Sanksionet penale sipas Kodit Penal të Maqedonisë

Para ndryshimeve në Kodin Penal të Maqedonisë në vitin 2004, legjislacioni penal njihet vetëm dy lloje dënimesh: **dënimin me burg dhe dënimi me të holla.** Me këto ndryshime, repertori i dënimeve është zgjeruar edhe me tre lloje të dënimeve që më parë ishin të parapara si masa të sigurisë. Sipas Kodit Penal të Maqedonisë për vepra penale,

¹⁵⁹. Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, vep. cit. f. 12.

¹⁶⁰. Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, vep. cit. f. 14.

¹⁶¹. Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, vep. cit. f. 19.

¹⁶². Dr. Ragip Halili, "Penologjia", Prishtinë 2005, f. 81.

kryerësve për vepra penale mund t'u shqiptohen pesë lloje të dënimeve: *burg, dënim me të holla; ndalimi i ushtrimit të profesionit, ndalimi i drejtimit të automjetit dhe dëbimi i të huajit nga vendi* (neni 33 p.1)¹⁶³

Dënimet ndahen në dy grupe: **kryesore dhe sekondare.**

Dënimet kryesore janë burgu dhe dënimi në të holla. Dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor (neni 33). Dënimi me të holla mund të shqiptohet si dënim kryesor edhe si sekondar së bashku me dënimin me burg ose dënimin me kusht me të cilin është paraparë dënimi me burg.¹⁶⁴

*Dënimet sekondare janë ndalimi i ushtrimit të profesionit, detyrës ose veprimtarisë, ndalimi i drejtimit të automjeteve dhe dëbimi i të huajit nga vendi.*¹⁶⁵

Sanksionet penale sipas Kodit Penal të Gjermanisë

Sipas Kodit Penal gjerman, mund të themi se ata përdorin këto lloje të dënimeve: ***klinikat psikiatrike, klinikat kundër alkoolizimit dhe drogës dhe gjithashtu mbajtja nën mbikëqyrje, heqja e disa të drejtave***, si p.sh.: heqja e lejes për drejtimin e automjetit apo heqja e të drejtës për ushtrimin e profesionit.¹⁶⁶

Sanksionet penale sipas Kodit Penal anglez

Sipas Kodit Penal anglez do ta përmendim ***dënimin me burgim*** i cili është dënimi më i rëndë. Aplikohet edhe për shkelësit e mitur 10 - 13 vjeç të dënuar për vrasje nga pakujdesia. Të gjithë ata që janë dënuar si fajtorë për vrasje me

¹⁶³. Vllado Kambovski, vep. cit. f. 478.

¹⁶⁴. Shih më gjerësisht Vllado Kambovski, “E drejta penale”, f. 478.

¹⁶⁵. Shih më gjerësisht Vllado Kambovski, “E drejta penale” f. 479.

¹⁶⁶. Altin Shegani, “E drejta penale e krahasuar”, Tiranë 2002, f. 162.

paramendim kur ishin 10 - 17 vjeç, mund t'u shkojë sanksionimi me burgim duke përfshirë këtu edhe pushtetin diskrecionar të madhërisë së tij. ***Izolimi në burgim*** jepet për këto vepra penale: vrasja me paramendim për të cilën dënimi me burgim të përjetshëm është dënim taksativ për këtë vepër penale, marrëdhëniet seksuale me dhunë, vrasje nga pakujdesia dhe rrëmbimet. Burgimi i përjetshëm mund të jepet për të gjithë personat nga 21 vjeç e më sipër që janë vërtetuar për vrasje me paramendim.¹⁶⁷

Sanksionet penale sipas Kodit Penal italian

Ndër llojet e sanksioneve mund të përmendim dënimin me *burgim të përjetshëm*, dënimin me *heqje lirie (kohë të kufizuar)*, *gjobën*, *konfiskimin* etj. Dënimet ndahen në dënime kryesore dhe dënime plotësuese. Llojet e dënimeve kryesore për krime janë:

1. Me burgim të përjetshëm,
2. Me burgim,
3. Me gjobë.

Ndërsa llojet e dënimeve për kundërvajtje janë:

1. Me burgim,
2. Me gjobë, (në Kodin Penal italian, dënimi në të holla nënkupton gjobën në të holla).

Si dënime plotësuese parashikohen:

1. Heqja e të drejtës për të ushtruar detyra shtetërore,
2. Heqja e të drejtës për të ushtruar një profesion ose mjeshtëri,
3. Heqja e të drejtës për të punuar në organet drejtuese të një personi juridik ose ndërmarrje,
4. Heqja e të drejtës për të kontraktuar me administratën shtetërore,

¹⁶⁷. Altin Shegani, vep. cit. f. 183-184.

5. Heqja e të drejtës ligjore,
6. Dekadenca dhe pezullimi i ushtrimit të pushtetit të prindit.¹⁶⁸

Sanksionet penale sipas Kodit Penal japonez

Dënimet kryesore klasifikohen sipas rëndësisë së veprës dhe rrezikshmërisë shoqërore të saj, *dënim me vdekje, dënim me burgim, dënim me burgim me punë të detyruar, burgim pa punë të detyruar, gjobë dhe konfiskim i objekteve fizike që përdoren në kryerjen e një vepre penale si dënim plotësues*.¹⁶⁹

Çështja e dënimit me vdekje

Dënimi me vdekje është lloji më i vjetër i dënimit në historinë e së drejtës penale. Një grup i vendeve përbëhet nga ato të cilat e kanë hequr me ligj dënimin me vdekje, kryesisht shtetet e Evropës Perëndimore dhe të Evropës Lindore që prej vitit 1990. Këto vende kanë nënshkruar kuadrin ligjor (konventa të ndryshme) lidhur me këtë problem. Konkretisht, dënimi kapital është hequr në Portugali në vitin 1867, në Holandë në vitin 1870, në Zvicër në vitin 1874, përveç disa krimeve në kohë lufte, në Gjermani dhe në Itali në vitin 1949, në Spanjë në vitin 1978, në Luksemburg në vitin 1979, në Francë në vitin 1981, në të gjitha vendet e Evropës Lindore që prej vitit 1990. (Këto vende kanë nënshkruar protokollin shtesë nr. 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut).¹⁷⁰

Një grup tjetër i vendeve përbëhet nga ato të cilat e kanë hequr, gjë e cila do të thotë se e drejta e tyre e

¹⁶⁸. Altin Shegani, vep. cit. f. 195-196.

¹⁶⁹. Altin Shegani, vep. cit. f. 259.

¹⁷⁰. Altin Shegani, vep. cit. f. 132.

brendshme e njeh dënimin kapital si sanksion, por praktika dëshmon qartë për një ngrirje të ekzekutimit të këtij dënimi. Mund të përmendim si të tilla Greqinë, Belgjikën, Marokun, Bregun e Fildishtë, Senegalin etj.

Brenda këtij kuadri përfshihet edhe Shqipëria e cila me hyrjen në Këshillin e Evropës ka ngrirë ekzekutimin e dënimit me vdekje. Një detyrim i tillë rrjedh nga nënshkrimi i protokollit 6 shtesë të Konventës Evropiane të të drejtave të njeriut për heqjen e dënimit me vdekje.¹⁷¹

Disa shtete të cilat e kanë abroguar dënimin me vdekje, në vend të tij e kanë paraparë dënimin me burgim të përjetshëm apo me burgim afatgjatë. Lidhur me këtë, duhet theksuar se të gjitha shtetet të cilat u formuan nga ish-territori i Jugosllavisë pas vitit 1991, e kanë abroguar dënimin me vdekje. Në Kosovë dënimi me vdekje është abroguar më 12 dhjetor 1999 me rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24. Maqedonia në vend të dënimit me vdekje e ka paraparë dënimin me burgim të përjetshëm, Sllovenia e ka paraparë dënimin me burgim deri në 30 vjet. Ndërsa Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova, në vend të dënimit me vdekje, e kanë paraparë dënimin me burgim afatgjatë deri në 40 vjet.¹⁷²

Vlen të theksohet edhe kjo se disa vende, përfshirë vendet të cilat e ruajnë akoma dënimin me vdekje, në këtë grup vendesh të konsiderueshme përfshihen pothuajse të gjitha vendet e Afrikës, pjesa më e madhe e Azisë dhe një numër i madh i shteteve të Amerikës (më shumë se gjysma e shteteve të SHBA-së dhe disa shtete të Amerikës Latine) dhe disa vende islamike si Arabia Saudite.

Në Kinë dënimi me vdekje mund të jepet i shoqëruar me një kusht prej 2 vjetësh dhe nëse nga koha e kushtit

¹⁷¹. Dr. Ragip Halili, vep. cit. f. 82.

¹⁷². Dr. Ismet Salihu, vep. cit. f. 452.

rezulton se i dënuari është penduar sinqerisht për veprën e kryer, dënimi me vdekje mund të kthehet në dënim me burgim të përjetshëm ose me burgim të përkohshëm (neni 43, paragrafi i kodit penal).¹⁷³

¹⁷³. Altin Shegani, vep. cit. f. 133.

PAJTIMET

Islami i ka kushtuar rëndësi të veçantë mundësisë së përçarjes së besimtarëve, ngase ata janë njerëz, gabojnë dhe ndonjëherë ia qëllojnë dhe nuk ka mundësi që përherë të janë në mendimet e tyre unik dhe të përbashkët. Pikërisht për këtë, islami e shëroi këtë problematikë në të gjitha nivelet e saj, duke filluar nga faza e grindjes, e braktisjes dhe e largimit të njëri-tjetrit e deri në fazën e fundit kur fillon luftimi dhe armiqësia ndërmjet tyre.

Kur jemi te vrasja si vepër penale në islam, të gjithë dijetarët islam janë unik në mendimet e tyre se pajtimi është veprim i lejuar kur është në pyetje ekzekutimi i sanksionit të kisasit - gjakmarrjes dhe me të bie ekzekutimi i kisasit - gjakmarrjes. Gjatë pajtimit nuk është me rëndësi nëse pajtimi bëhet me më shumë *dije* apo me më pak, me pagim të menjëhershëm apo me vonesë. Në lidhje me këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë:

الصلح جائز بين المسلمين إلا صلحا أحل حرام حلا لا
أوحرام

“Pajtimi është i lejuar mes besimtarëve, me përjashtim të pajtimit i cili lejon të ndaluarën, apo e ndalon të lejuarën.”¹⁷⁴

Personi i cili ka të drejtë të faljes, i njëjti ka të drejtë edhe pajtimi.

¹⁷⁴. Transmeton Ebu Davudi.

Rëndësia e pajtimit

All-llahu xh.sh. thotë:

وَالصُّلْحُ خَيْرٌ

“Pajtimi është më i dobishmi”.¹⁷⁵

Me pajtim, ummetit (kombit) i realizohet njësimi dhe unifikimi, ku gjen krenari i dobëti, humb e padrejta, forcohen lidhjet dhe nxitohet në pajtim të përgjithshëm.

All-llahu xh.sh. thotë:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأَصْلَحُوا بَيْنَ أَخَوِيكُمْ وَأَتَّقُوا

اللَّهِ لَعَلَّكُمْ تَرْحَمُونَ

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).”¹⁷⁶

Nëse humb pajtimi, atëherë shkatërrohen popujt, shkelet nderi dhe përhapet e keqja te i afërmi dhe te ai që është larg.

Fusha e pajtimit

në mes individëve dhe shoqërive

Transmeton Buhariu nga Sehl bin Sa’di se: *“Banorët rreth xhamisë Kuba ishin armiqësuar ndërmjet vete, saqë edhe e kishin gjuajtur njëri-tjetrin me gurë. Kur e lajmëruan*

¹⁷⁵. En Nisa, 128.

¹⁷⁶. El Huxhurat, 10.

Pejgamberin a.s. për këtë, ai tha: “Ejani të shkojmë dhe t’i pajtojmë.”

Në mes fiseve dhe grupeve

Transmeton Enesi r.a.: “I është thënë Pejgamberit a.s.: “Sikur të shkoje te Abdullah b. Ubejji.” U nis për te ai dhe hipi mbi një gomar, ndërsa muslimanët u nisën pas tij. Ajo tokë ishte e tharë (nuk mbinte asgjë në të). Kur shkoi Pejgamberi a.s., Abdullahu i tha: “Rri më larg ngase më shqetësoi era e gomarit tënd!” Një medinas tha: “Pasha All-llahun! Era e gomarit të Pejgamberit a.s. është më e mirë sesa era jote.” Një njeri i fisit të Abdullahut u hidhërua në të dhe shau. Në të dy ata u hidhëruan shokët e tij (të pejgamberit a.s.). Në mes tyre (sahabëve dhe atyre që atëbotë ishin mosbesimtarë) kishte pasur edhe goditje me shkopinj, grushtime dhe sandale. Jemi informuar se në lidhje me këta njerëz ka zbritur ajeti kur`anor:

وَإِنْ طَائِفَتَانِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا

“ Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata...”¹⁷⁷

Perceptimi i Pajtimit

Pajtimi është vendosmëri e lëvduar, nijet i mirë, dëshirë dhe vullnet i qëlluar, ummeti ka nevojë për pajtim, përmirësim, ka nevojë që të armiqësuarit të bëhen miq, ata që janë kacafytur të pajtohen në mënyrë që rehatia dhe qetësia të zë vend në mesin e tyre dhe të mos ketë grupe përveç se për të bërë gara se kush bën më shumë vepra të mira.

¹⁷⁷. El Huxhurat, 9.

Pajtimi ka domethënien e vet, i ka rrugët dhe metodat të cilat kanë zënë vend në tekstet fetare islame dhe të cilat i kanë zbatuar njerëzit reformator në të kaluarën. All-llahu thotë në Kur'an:

فَإِنْ فَاءَتْ فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا بِالْعَدْلِ وَأَقْسِطُوا إِنَّ اللَّهَ

حُبُّ الْمُقْسِطِينَ

“...atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre, mbani drejtësinë, se vërtet All-llahu i do të drejtët.”¹⁷⁸

Që pajtuesi të jetë i mençur, në mënyrë që çdonjërit t'ia japë të drejtën dhe në vend të armiqësisë të mbjell miqësi dhe dashuri.

Shkuarja pas metodologjisë së të folurit me zë të ulët, edhe pse kjo mënyrë është e urryer, megjithatë në këtë rast është e pranuar. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

لَا خَيْرَ فِي كَثِيرٍ مِّنْ نَّجْوَاهُمْ إِلَّا مَنْ أَمَرَ بِصَدَقَةٍ

أَوْ مَعْرُوفٍ أَوْ إِصْلَاحٍ بَيْنَ النَّاسِ

“Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve.”¹⁷⁹

Zgjedhja e kohës adekuate për pajtim në mes të dy palëve të armiqësuar, në mënyrë që pajtimi t'i japë frytet e tij dhe që të jetë më ndikues në zemrat e njerëzve. Pajtimi të jetë i themeluar mbi shkencën islame, e cila të armiqësuarit i

¹⁷⁸. El Huxhurat, 9.

¹⁷⁹. En Nisa, 114.

nxjerr nga dëshpërimi në gëzim, nga përçarja në bashkim, nga urrejtja në dashuri.

Butësia gjatë pajtimit dhe lënia e qortimit, ngase qortimi të sjell urrejtje ndërsa butësia të sjell dashuri. Omeri r.a. i kishte shkruar Ebu Musa El Esh`ariut: “*Ktheji armiqësitë derisa të pajtohen ndërmjet vete ngase gjykimi i prerë (pa dashur të arrihet një pajtim në mes tyre) trashëgon te ata urrejtje.*”

Urdhri kur`anor për pajtim në mes njerëzve:

فَأَصْلَحَ بَيْنَهُمْ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“...ai që bën pajtim ndërmjet tyre, ai nuk ka mëkat. Vërtetë All-llahu shumë falë dhe shumë mëshiron.”¹⁸⁰

Gjithashtu All-llahu në lidhje me këtë thotë:

وَلَا تَجْعَلُوا اللَّهَ عُرْضَةً لِأَيْمَانِكُمْ أَنْ تَبَرُّوا وَتَتَّقُوا

وَتُصْلِحُوا بَيْنَ النَّاسِ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“E mos e bëni All-llahun peng të betimeve tuaja (kur betoheni në Të), kur doni të bëni vepra të mira, të silleni mirë dhe të bëni pajtim ndërmjet njerëzve. All-llahu i dëgjon të gjitha dhe i di.”¹⁸¹

¹⁸⁰. El Bekare, 182.

¹⁸¹. El Bekare, 182.

Vlera e pajtimit dhe e pajtuesit.

All-llahu xh.sh. në lidhje me këtë thotë:

وَجَزَاءُ سَيِّئَةٍ سَيِّئَةٌ مِّثْلُهَا فَمَنْ عَفَا وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ

عَلَى اللَّهِ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ

“Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtëm, shpërblimi i tij është te All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët.”¹⁸²

Pejgamberi a.s. në lidhje me vlerën e pajtimit ka thënë: “A t’ju rrëfej për diçka që i tejkalon gradat e agjërimit, namazit dhe zekatit,” i pyeti Pejgamberi a.s. shokët e vet? (Bëhet fjalë për agjërimin dhe namazin nafile e jo për farzet) Thanë: “Po, gjithsesi.” Tha: “Pajtimi ndërmjet njerëzve, ngase prishja e marrëdhënieve në mes tyre është korrëse (e fesë).”

Enesi r.a. ka thënë: “Kush i pajton dy njerëz, All-llahu për çdo fjalë do t’ia japë shpërblimin e lirimit të një robi.”

Shihabi ka thënë: “Nuk kam dëgjuar të jetë lejuar gënjeshtër në diçka, me përjashtim në tri gjëra: në luftë, në pajtimin në mes njerëzve dhe burri kur t’i flet gruas (për diçka në mes veti).”

¹⁸². Esh Shura, 40.

Përfundimi

Njeriu është ai që planifikon, ndërsa All-llahu xh.sh është Ai që e realizon atë që do. E falënderoj All-llahun e Plotfuqishëm që ma mundësoi t'i dal në fund këtij punimi të temës së diplomës. Ky punim ishte një sfidë e madhe por e përballueshme për mua, në të njëjtën kohë edhe një përvojë shumë e mirë dhe e madhe për mua. Kjo njëherësh ka qenë edhe vullneti im që të bëj diçka të tillë si kjo. Gjatë këtij punimi kam hasur në disa pengesa të vogla, të cilat deshi All-llahu xh.sh i kalova pa vështirësi, si në gjetjen e materialit, në përkthimin e disa teksteve nga arabishtja etj. Nga ky punim mësova se si të përgatitet një punim shkencor. Në këtë punim jam munduar që të shtjelloj në pika të shkurtra gjithë atë që e kam pasur në njohuritë e mia. Pa dyshim se tema në fjalë ka mangësitë e veta dhe shpresoj se do të kem këshilla, kritika, sugjerime, mirëpo të gjitha janë të mirëse-ardhura, ngase këto lëshime që i kam bërë gjatë punimit, shpresoj që në të ardhmen t'i përmirësoj ato. Shpresoj që kjo temë do t'ju ndihmojë lexuesve dhe të kuptojnë se vrasja dhe armiqësia ndaj vëllait të tij dhe njerëzve në përgjithësi është e ndaluar dhe nuk sjell asnjë dobi në jetën e tij. Pa dyshim se unë këtë temë nuk e kam shprehur gjithë atë që është e domosdoshme dhe sigurisht se edhe dikush do të shkruaj në lidhje me këtë temë.

Literatura:

1. ABDULLA EL-GAMIDI, “Sukut el-ukubat”, Medinë 1989.
2. ABDULKADËR AUDE, “Eteshriul xhinai”, Kajro 1969.
3. Dr. ABDULKADËR AUDE, “Eteshriu el-xhinai el-islami mukaren bil kanun el-vedi”, Kajro 1966.
4. ABDULKERIM ZINDANI, “El-Medkhal li dirasat esh-sheriatul islamije”, Bagdad 1992.
5. AMËR HALID, “Përmirësimi i zemrave”, Tiranë 2005
6. AJNI SINANI, “Islami, ligj, kulturë dhe qytetërim”, Prishtinë 2007.
7. ALTIN SHEGANI, “E drejta penale e krahasuar”, Tiranë 2002.
8. ARBEN PUTO, “E drejta ndërkombtare publike”, Tiranë 2002.
9. A. SERRAXHI, “Kanunul kubat”, Damask 1999.
10. DITURIA ISLAME, Revistë mujore, fetare, kulturore, shkencore, Prishtinë.
11. EBU BEKËR EL-XHEZAIRI, “Minhaxh el-muslim”, Tiranë 2005.
12. EL MAVERDI, “Ahkam es-sulltanije”, Kajro 1983.
13. EKREM MURTEZAI, “Fjalor i terminologjisë fetare”, Prishtinë 2007
14. FET`HUL BARI, vëllimi 15.
15. FEJZULLA HASANI, “Vepra penale, vrasja në afekt”, punim magjistrature, Prishtinë 1999.
16. FLAMUR SEFIJU, “Jurisprudenca islame 4”, Prishtinë 2001.

17. HARUN JAHJA, “Islami dënon terrorizmin”.
18. HADITHE TË ZGJEDHURA TË PEJGAMBERIT A.S., Tetovë 2003.
19. IBNI RUZHDI, “Bidajetul muxhtehid”, Kajro 1379.
20. Dr. ISMET SALIHU, “Vrasjet në Kosovë”, Prishtinë 1985.
21. Dr. ISMET SALIHU, “E drejta penale”, pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2003.
22. Dr. ISMET ELEZI, “Njohuri për të drejtën zakonore mbarëshqiptare”, Prishtinë 2003.
23. H. HAFIZ IBRAHIM DALLIU, “Ajka e kuptimeve të Kur`ani kerimit”, Tiranë 2005.
24. Dr. JUSUF EL-KARDAVI, “El Iman vel Hajat”, Kajro.
25. Dr. JUSUF EL-KARDAVI, “Hallalli dhe harami në Islam”, Prishtinë 2002.
26. Prof. JUSUF ZIMERI, “Dispencë për vitin e IV të shkollës së mesme islame”, MIB Shkup 1998.
27. KEMAL XHEUDET EBU EL-ATA MUSTAFA, “Ukubu el-xhinaije ala en-nefs”, Kajro 1986.
28. KODI I PËRKOHSHËM PENAL I KOSOVËS, UNMIK/RREG/2003/25
29. KANUNI I LEKË DUKAGJINIT.
30. KLASIFIKIMI TEMATIK I AJETEVE KUR`ANORE, SHKUP 1995.
31. KUR`ANI KERIM, me përkthim në gjuhën shqipe nga SHERIF AHMETI.
32. Dr. MUHAMED SHILAL EL-ANI, “Teshriul xhinai el-islami”, Irbid 1998.
33. Dr. MUHAMED EBU ZEHRA, “El-xherime vel kube”, Kajro 1970.

34. Prof. Dr. MUHAMED SEID RAMADAN EL - BUTI “Të vërtetat e patundshme të besimit islam” Tetovë 2004

35. MUSNED, “El-Imam Ahmed”, vëllimi 12.

36. NEXHAT IBRAHIMI, “Shkolla juridike hanefite dhe karakteristikat themelore të doktrinës së saj”, Prizren 2000.

37. NIKOLLA M. NIKOLLOV, “Komploti botëror”, Tetovë 1998.

38. Dr. RAGIP HALILI, “Penologjia”, Prishtinë 2005

39. RISALET EL-XHIHAD, nr. 61, 1987.

40. SALIH BIN HUSEJN EL – AJID “Të drejtat e jomyslimanëve në shtetin islam” Shkup 2005

41. SEFUJIRRAHMAN EL-MUBAREKFURRI, “Nektari i vulosur i xhenetit”, Prishtinë 2004.

42. SAHIHU MUSLIM, vëllimi 1, 2, 3,

45. SUNEN ET-TIRMIDHIJ, “Ed-dijat”, vëllimi 5.

46. SHAQIR FETAHU, “Feja-fenomen i vërtetë”, Shkup 1997.

47. SHERIF AHMETI, “Komente dhe mendime islame”, Prishtinë 1995

48. TAKVIMI, “Kalendari 2006, nr. 36”, Prishtinë.

49. Dr. VESEL LATIFI, “Kriminalistika”, Prishtinë 2001.

50. Dr. VEHBI ZUHEJLI, “Fikhul el-islami”, Damask 1988.

51. Dr. VEHBI ZUHEJLI, “El fik`hul islamij ve ediletuhu”, Kajro 1992.

52. VEPRRA, revistë edukative, kulturore dhe shkencore, Furkan ISM Shkup.

53. VLLADO KAMBOVSKI. “E drejta penale”, pjesa e përgjithshme, Shkup 2007.

54. Dr. ZEJNULLA GRUDA, “Mbrojtja e të drejtave të njeriut në konflikte të armatosura”, Prishtinë 2005.

55. Dr. ZEJNULLA GRUDA, “Mbrojta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut”, boton Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2001.

Përmbajtja:

Hyrje	5
-------------	---

KAPITULLI I PARË

MBYTJA (vrasja)	9
NJERIU DHE VLERA E TIJ	11
HISTORIKU I MBYTJES (I VRASJES) SË NJERIUT	18
MBYTJA (vrasja) NË LUFTËRA DHE KONFLIKTE	21
MBYTJA (vrasja) NË TRADITA DHE ZAKONE	29

KAPITULLI I DYTË

MBYTJA (vrasja) NË ISLAM	35
VLERA E NJERIUT NË ISLAM	37
MBYTJA (vrasja) E NJERIUT PA TË DREJTË NË ISLAM ËSHTË E NDALUAR DHE ËSHTË KRIM, GJYNAH (MËKAT)	42
VETËDIJA FETARE DHE NDIKIMI I SAJ NË PENGIMIN E MBYTJES (vrasjes)	48
ISLAMI E NDËSHKON MBYTËSIN (vrasësin)	57

KAPITULLI I TRETË

MBYTJA (vrasja) SIPAS TË DREJTËS SË SHERIATIT	61
MBYTJA (vrasja) VEPËR PENALE	63
LLOJET E MBYTJES (vrasjes)	66
MBYTJA ME QËLLIM	66
MBYTJA SI ME QËLLIM	70
MBYTJA ME GABIM	71
SANKSIONET (MASAT NDËSHKIMORE) E VEPRËS PENALE SIPAS SHERIATIT	73

SANKSIONET E VEPRËS PENALE “MBYTJE ME QËLLIM” ...	78
1. SANKSIONET KRYESORË	78
2. SANKSIONI ALTERNATIV - ZËVENDËSUES	90
3. SANKSIONI PASUES	94
SANKSIONI I VEPRËS PENALE “MBYTJA SI ME QËLLIM” ..	96
SANKSIONET E VEPRËS PENALE “MBYTJE ME GABIM”	98
SANKSIONET (MASAT NDËSHKIMORE) NË	
LIGJET TJERA	103
PAJTIMET	112
Përfundimi	118
Literatura:.....	119

**I falënderoj të gjithë ata që e mbështetën dhe e
sponzoruan këtë libër.
Allahu i begatofte me të mira?**